



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 221 Akti

Nr. 417 Vendimi
Tiranë, më 8.7.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Pamela Qirko	Kryesuese
Suela Zhegu	Relatore
Lulzim Hamitaj	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, në datën 8.7.2021, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Lindita Sinanaj**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Pika 5 e nenit 179/ b të Kushtetutës, pika 1 e nenit Ç, dhe nenet D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Lindita Sinanaj, me detyrë gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit, *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.11.2018, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

2. Me vendimin nr. 1, datë 4.12.2018, të trupit gjykues, i cili është ngritur me vendimin nr. 60 datë 27.11.2018, të Komisionit është vendosur pranimi i kërkesës për dorëheqje të komisioneres Genta Tafa (Bungo), nga shqyrtimi i çështjes për subjektin Lindita Sinanaj, duke u zëvendësuar me anëtarin zëvendësues të trupit gjykues, me komisioneren Brunilda Bektshi. Në vijim, komisionere Brunilda Bektshi ka kërkuar dorëheqje nga shqyrtimi i kësaj çështjeje, e cila është shqyrtuar nga një trup gjykues i caktuar me vendimin nr. 67, datë 11.12.2018, të Komisionit, i cili ka vendosur pranimin e dorëheqjes së komisioneres Brunilda Bektshi nga shqyrtimi i çështjes. Me vendimin nr. 68, datë 20.12.2018, të Komisionit është caktuar komisionere Pamela Qirko në përbërjen e trupit gjykues që do të shqyrtojë çështjen e subjektit të rivlerësimit Lindita Sinanaj.

3. Trupi gjykues i përbërë nga komisionerët: Lulzim Hamitaj, Suela Zhegu dhe Pamela Qirko i mbledhur në datën 21.12.2018, në mbledhjen e parë, caktuan me mirëkuptim kryesues të trupit gjykues znj. Pamela Qirko. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Vëzhguese ndërkombëtare për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar znj. Elka Ermenkova. Subjekti i rivlerësimit u njoh me anëtarët e trupit gjykues dhe deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit me komisionerët. Në datën 7.6.2021 subjekti u njoftua për përfundimin kryesisht të hetimit administrativ.

4. Procesi i rivlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV “vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, si dhe veçanërisht me nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin, deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

5. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Kualifikuar (në vijim DSIK); dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).

6. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konkluduar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin,*
- *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

7. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar²(DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar.

8. Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGj)³ ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016 dhe pesë dokumentet e tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar mbi subjektin e rivlerësimit.

9. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

10. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes në datën 21.6.2021, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht duke u bazuar në të tria kriteret: në vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, në përputhje me pikën 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit Lindita Sinanaj, njoftimin e këtij subjekti për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, rezultatet paraprake të hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe duke i kaluar barrën e provës, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

11. Për një proces të rregullt ligjor subjektit të rivlerësimit, i janë garantuar të drejtat, si: njoftimi për fillimin e procedurës së rivlerësimit; njoftimi mbi përbërjen e trupit gjykues; dhe për përfundimin kryesisht të hetimit administrativ, duke i kaluar barrën e provës mbi rezultatet e hetimit. Në datën 7.6.2021, subjektit iu dërguan rezultatet paraprake të hetimit administrativ dhe iu dha koha e nevojshme për t'u njohur me dosjen dhe për të disponuar kopje të saj.

¹Me shkresën me nr. *** prot., datë 8.6.2018.

²Me nr. *** prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar me vendimin nr. **, datë 30.3.2021, të KDZh-së.

³Me shkresën nr. **** prot., datë 14.2.2019.

12. Znj. Lindita Sinanaj, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, ka paraqitur shpjegimet dhe provat në datën 21.6.2021. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me rezultatet e hetimit, deklaroi se nuk është dakord me gjetjet e konstatuara nga hetimi i kryer nga Komisioni.

13. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe të provave të vëna në dispozicion nga subjekti, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

14. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e kryer elektronikisht në datën 24.6.2021. Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 6.7.2021, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, salla B, kati 0, Tiranë, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova.

15. Në përfundim, të seancës dëgjimore, subjekti nuk pranoi rezultatet e hetimit të kryera nga Komisioni dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

16. Subjekti i rivlerësimit Lindita Sinanaj, ka qenë bashkëpunuese gjatë procesit të rivlerësimit në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, znj. Lindita Sinanaj, ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

17. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

18. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

19. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

20. Ndërsa, sipas kreut V, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

21. Referuar vendimit nr. 2/2017, të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë

kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

22. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*”;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara, ndër vite, nga subjekti në ILDKPKI;
- d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private;
- e) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- f) raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ;
- g) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- h) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

23. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, kreu një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, i cili konsistoi në verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore, me burimet e krijimit, të ardhurat, shpenzimet, mundësitë për fshehje të pasurisë, deklarim të rremë apo konfliktin e interesit.

24. Në deklaratën e pasurisë *Vetting* (shtojca 2), dorëzuar në ILDKPKI, në datën 27.1.2017, subjekti ka deklaruar pasuritë në vijim:

1. Apartament banimi, me sip. 83.3 m², në Fier

Vlera e deklaruar: 3.900.000 lekë.
Burimi i krijimit: me kursimet familjare ndër vite.
Deklarimi në DPV: e vitit 2003, nuk është deklaruar burim krijimi për këtë pasuri.
Mënyra e fitimit: blerë me kontratën nr. ***, datë 26.4.2000.
Statusi aktual: pasuri e tjetërsuar në datën 16.1.2016.

1.1 Hetimi i kryer nga Komisioni

Komisioni ka hetuar pasurinë apartament në Fier, edhe pse *de facto* është pasuri e tjetërsuar në pronësi të I e D.B, pasi subjekti ka deklaruar se të ardhurat nga shitja e këtij apartamenti janë përdorur si burim për blerjen e pasurisë apartament banimi në Tiranë.

Gjatë hetimit, subjekti ka shpjeguar se: “*Apartamenti është blerë me kursimet familjare, ndër vite, në çmimin 3.900.000 lekë. Ky apartament është shitur kundrejt shumës 73.000 euro, vlerë e cila është përdorur për blerjen e apartamentit në Tiranë. Shitja e banesës është bërë me kontratën e shitblerjes me nr. ***, datë 21.1.2016, pas pagesës finale të shumës prej 5.000 euro, të mbetur pa shlyer nga çmimi i shitjes së banesës*”.

ASHK-ja Drejtoria Vendore Fier⁴ ka konfirmuar se shtetasi M. Sh. S, ka pasur të regjistruar pasurinë “apartament” me sip. 83.3 m², nr. ***, z. k. ***, vol. *, f. **, e cila me kontratë shitje ka kaluar në favor të shtetasve I dhe D.B, në datën 5.2.2016.

Drejtoria e ALUIZNI-t Fier⁵ ka informuar se shtetasi M.S, figuron të jetë vetëdeklarues në proces legalizimi me aplikimin që mban nr. *** prot., datë 19.11.2014, për objektin e ndodhur në lagjen “* T”, Fier.

Bashkëlidhur përgjigjes rezulton deklarata për përfshirjen në procedurat e legalizimit të ndërtimit pa leje dhe/ose shtesës në ndërtim me leje, nga shtetasi M.Sh.S, datë 19.11.2014, në të cilën deklarohet se ka ndërtuar shtesë anësore në ndërtimin me leje. Ky ndërtim është ngritur në vitin 2008, në adresën lagjja “** T”, Fier. Nga deklarata, nuk rezulton se sa është sipërfaqja ndërtimore e shtuar.

1.2 Në lidhje me “shtesën”, subjekti ka shpjeguar⁶ se: *“Në vitin 2014, bashkëshorti M. S, ka deklaruar pranë ish-ALUIZNI-t Fier, ndërtimin e një ‘shtese anësore’, në banesën 2+1 të ndodhur në lagjen ‘* T’, Fier. Një fakt i tillë nuk është deklaruar prej saj në deklaratat vjetore, pasi nuk ka ndryshuar sipërfaqja ndërtimore e shfrytëzueshme e banesës, por sipërfaqja e ballkonit ekzistues të banesës i është përshtatur ambienteve të brendshme të banesës, duke u mbyllur, konkretisht, është zgjeruar sipërfaqja e aneksit dhe guzhinës, por brenda sipërfaqes ekzistuese të shfrytëzueshme të banesës.*

Lidhur me këtë fakt, sqaroj se përpara se të shitej banesa, konkretisht në muajin shtator 2013, është bërë rivlerësimi i saj, për efekt të të cilit është paraqitur në ish-ZVRPP-në Fier, raporti i vlerësimit për banesën në fjalë, i përpiluar nga eksperti vlerësues ing. P. Gj.

Në përshkrimin e banesës, sipas ekspertit vlerësues nuk tregohet shtesë anësore dhe, për më tepër, në fotot e banesës bashkëlidhur Raportit të Vlerësimit konstatohet fakti i mbylljes së ballkonit të banesës.

Deklarimi për legalizim është bërë në kushtet kur banesa ishte shitur dhe pjesa e mbyllur e ballkonit ishte fasadë dhe banesa ndodhej në një prej rrugëve në qendër të qytetit”.

Sipas deklaramit për legalizim, të depozituar pranë ALUIZNI-t – nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit më 19.11.2014, deklarohet se ndërtimi ka përfunduar në vitin 2008. Referuar deklaramive periodike të dorëzuara, ka rezultuar se subjekti nuk ka deklaruar kryerjen e këtyre punimeve, si dhe shtesën apo mbylljen e ballkonit për sipërfaqet e ndryshuara, as shumën e shpenzuar për kryerjen e këtyre punimeve.

Subjekti i rivlerësimit, i pyetur nga Komisioni, për arsyet e mosdeklarimit në deklaramin periodik vjetor⁷ ka shpjeguar se punimet kanë kushtuar në shumën 200.000 lekë dhe janë paguar në vitin 2008.

⁴Me shkresën nr. *** prot., datë 15.11.2019.

⁵Me shkresën nr. *** prot., datë 31.8.2017.

⁶Në përgjigjet e pyetësorit ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 14.1.2021.

⁷Ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 14.1.2021.

1.3 Komisioni analizoi burimet e krijimit për apartamentin në Fier

Apartamenti në Fier është blerë nga subjekti dhe bashkëshorti gjatë kohës që ka ushtruar detyrën e gjyqtares. Në deklarimin e parë të subjektit të vitit 2003, është deklaruar banesa në Fier me sipërfaqe 80 m², në bashkëpronësi me ¼ pjesë takuese, e blerë në çmimin 3.900.000 lekë.

Nga aktet e administruara rezulton një kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 26.4.2000, me palë blerëse M.S, për pasurinë apartamentin në Fier, me sipërfaqe ndërtimorë 83.3 m², në vlerën 3.900.000 lekë, shumë e likuiduar jashtë zyrës noteriale.

Si burim krijimi në deklaratën *Vetting* është deklaruar me “kursimet familjare”, e cila përputhet me deklarimin për herë të parë në vitin 2003. Gjatë procesit të rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit⁸, subjekti i rivlerësimit ka saktësuar se:

- kursimet familjare, kanë qenë në shumën: 1.500.000 lekë;
 - si dhe duke shtuar burimet e mëposhtme:
 - të ardhurat e dhëna nga prindërit e subjektit në shumën 1.950.000 (nga shitja e apartamentit në Fier në vitin 2000); si dhe
 - të ardhurat e krijuara nga prindërit e bashkëshortit nga bujqësia, në shumën 600.000 lekë.
- Për të mbështetur shpjegimet e mësipërme, u depozitua dhe dokumentacion⁹ provues.

⁸Në përgjigjet e pyetësorit depozituar nga subjekti me nr. *** prot., datë 14.1.2021.

⁹Për të provuar faktet e mësipërme, subjekti ka depozituar akte shkresore:

- kthim përgjigje nr. *** prot., datë 7.11.2019, e DRSSH-së Fier lidhur me të ardhurat për subjektin Lindita Sinanaj në Gjykatën e rrethit Gjyqësor Fier;
- vërtetim nga DRSSH-ja Fier lidhur me të ardhurat e subjektit Lindita Sinanaj për periudhën 1994 – 1996;
- vërtetim nga DRSSH-ja Fier lidhur me të ardhurat e subjektit Lindita Sinanaj për periudhën 1997 – 2000;
- vërtetim nga DRSSH-ja Fier lidhur me të ardhurat e subjektit Lindita Sinanaj për periudhën 2001 – 2004;
- vërtetim nga DRSSH-ja Fier lidhur me të ardhurat e subjektit Lindita Sinanaj për periudhën 2005 – 2008;
- vërtetim nga DRSSH-ja Fier për të ardhurat e subjektit Lindita Sinanaj për periudhën 2009 – 2011;
- AMTP-ja nr. ***, lëshuar në emër të shtetasit Sh. S;
- dosja e pensionit për shtetasen H. S që provon se është e siguruar si e vetëpunësuar në bujqësi për periudhën 1993 – 1998;
- vërtetim nr. *** prot., datë 10.9.2019, i DRSSH-së Fier, lidhur me të ardhurat nga pensioni i pleqërisë për shtetasen H.S;
- vërtetim nr. *** prot., datë 11.11.2019, i DRSSH-së Fier, lidhur me të ardhurat nga pensioni i pleqërisë për shtetasin Sh.S;
- vërtetim nr. *** prot., datë 19.12.2019, i Bashkisë Mallakastër, lidhur me pagimin e gjithë detyrimeve tatimore nga shtetasi Sh.S;
- kontrata nr. ***, datë 8.5.1998, për apartamentin në lagjen “8 Shkurti”, me palë shitëse S e L. Ç dhe blerës Sh. R;
- kontrata nr. ***, datë 22.6.2000, me palë shitëse Sh e S.R dhe blerës B. F;
- shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 20.11.2019, nga “Albtelecom”, bashkëlidhur të cilës janë aktet: kontrata e shërbimit telefonik nr. *** , datë 15. 7.1996, e lidhur ndërmjet Telekomit Fier dhe përdoruesit telefonik Lindita Sinani; modelari tip “Mbi instalimet telefonike” nr. *** , datë 18.7.1996; kontrata e abonimit në rrjetin telefonik publik të Telekomit Shqiptar nr. *** , datë 14.8.1998, e lidhur me abonentin Lindita Sinani, për numrin telefonik ***,k e abonimit në rrjetin telefonik publik nr. *** , datë 11.7.2000. Aktet e mësipërme konfirmojnë adresat ku ka qenë instaluar numri i telefonit fiks ***, numër që ishte në përdorim prej meje dhe, për pasojë, edhe adresat e banimit;
- kontrata e privatizimit të banesës së ndodhur në lagjen “15 Tetori”, nga Sh.R, në bazë të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, si dhe kartela e pasurisë së kësaj banese, që konfirmon faktin që familja e prindërve ka pasur banesë tjetër në pronësi, ku edhe jetonte, si dhe faktin se në këtë banesë ka qenë edhe subjekti bashkëpronar;
- shkresë nr. *** prot., datë 1.10.2019, e DRT-së Fier, lidhur me ushtrimin e aktivitetit prej subjektit S.R (mamaja ime);
- shkresë nr. *** prot., datë 23.10.2019, e DRSSH-së Tiranë, bashkëlidhur të cilës akti “vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare”, marrë nga dosja e pensionit me nr. kartele ***, në emër të S.R (akti në fjalë konfirmon faktin e ushtrimit të aktivitetit privat prej nënës së subjektit deri në vitin 2003);
- kontrata e qirasë, datë 8.2.1993, e mbajtur në Degën e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit Fier;
- autorizimi i privatizimit nr. *** , datë 20.2.1993, i Degës së Agjencisë Kombëtare të Privatizimit Fier;
- vërtetimi, datë 20.2.1993, i lëshuar nga Dega e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit Fier, lidhur me pagesën e kryer për llogari të privatizimit;
- certifikatë e regjistrimit në organin tatimor me nr. Serial ***, për vitin 1996;
- vërtetim i ISSH-së për të ardhurat nga pensioni për shtetasin Sh.R;
- kërkesë drejtuar KLGJ-së lidhur me pagën në periudhën 1993 – 1998.

1.4 Në lidhje me burimet shtesë të deklaruar, Komisioni ka konstatuar se:

1. Për shumën 1.950.000 lekë të dhënë nga prindërit e subjektit, si të përfituar nga shitja e apartamentit në Fier, më 22.6.2000, nga verifikimi i aktit të shitjes rezultoi se :

- a. këto të ardhura nuk mund të kenë shërbyer si burim, pasi apartamenti i prindërve është shitur më 22.6.2000, 2 muaj pasi subjekti ka blerë apartamentin e saj, në datën 26.4.2000;
- b. këto të ardhura nuk janë deklaruar si burim as në DPV-në e parë, por as në deklaratën *Vetting*.

2. Për shumën 600.000 lekë të dhënë si dhuratë nga prindërit e bashkëshortit, me burim nga aktiviteti bujqësor i tyre, Komisioni vëren se:

- a. këto të ardhura nuk janë deklaruar si burim për pasurinë as në deklarinimin e parë e as në deklaratën *Vetting*;
- b. subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur ndonjë provë rreth periudhës konkrete kur janë dhëna këto shuma, për të provuar mundësinë financiare të dhuruesve;
- c. subjekti nuk arriti të dokumentonte të ardhurat që prindërit e bashkëshortit kanë realizuar duke ushtruar aktivitet bujqësor.

1.5 Komisioni, në analizën financiare, ka analizuar mundësinë e blerjes së apartamentit në vitin 2000, duke marrë në konsideratë burimet e deklaruar në deklaratën *Vetting*, bazuar në dokumentacionin provues që subjekti ka venë në dispozicion për periudhën nga 1994 - prill 2000, sipas tabelës vijuese:

Përshkrimi	1994 - 2000
Pasuri apartament	3 900 000
Të ardhurat nga pagat e subjektit	1 666 203
Të ardhurat nga pagat e bashkëshortit	1 184 764
Total të ardhura	2 850 967
Shpenzime jetese	1 881 638
Rezultati financiar	- 2 018 362

1.6 Konstatime të Komisionit

Për apartamentin e blerë në Fier në vitin 2000, u konstatua se:

- a. nga analiza e kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor, ka rezultuar mungesë burimesh të ligjshme, në shumën 2.018.362 lekë, për blerjen e kësaj pasurie;
- b. në deklaratën *Vetting* nuk është deklaruar saktë burimi i krijimit të kësaj pasurie.

Në lidhje me këto konstatime, për pasurinë apartament në Fier, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në pikën 5, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

1.7 Në lidhje me vlerën e mobilimi për apartamentin në Fier

Sipas deklarimeve të subjektit dhe kontratës premtim-shitje¹⁰, mobiliet e apartamentit në Fier, janë shitur në vitin 2012, në shumën 18.000 euro.

Nga verifikimi i deklarimeve periodike vjetore, Komisioni konstatoi se subjekti nuk ka deklaruar shpenzime mobilimi në banesë. I pyetur nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të detajuara mbi mobilimin e apartamentit të kryer ndërmjet viteve 2006 – 2010 me një kosto të përgjithshme prej 2.600.000 lekësh, të ndarë si vijon:

- a) në vitin 2006, në vlerën 300.000 lekë, janë vendosur kondicionerët në sallon dhe në dhomën e gjumit, si dhe është blerë lavatriçja dhe tharësja e rrobave;
- b) në vitin 2007, në vlerën 400.000 lekë është mobiluar dhoma e gjumit në çdo element të saj, duke përfshirë edhe perdet, ndriçuesit, piktura, etj.
- c) në vitin 2008, ka shpenzuar vlerën prej 700.000 lekë, në kushtet kur në fund të vitit 2008, sikurse ka shpjeguar edhe në pyetjen 2, kanë bërë rikonstrukcion të brendshëm të banesës në pjesën e dhomës së gatimit, e cila është mobiluar në tërësinë e saj, konkretisht është bërë kuzhina, është blerë frigoriferi, soba, lavastovilja, mikrovala, si dhe ndriçuesit, perdet e ambienteve përkatëse, etj;
- d) në vitin 2009, ka shpenzuar vlerën 800.000 lekë, pasi janë blerë kolltukët së bashku me tavolinën, televizori së bashku me etazherin mbajtës, tavolina e ngrënies së bashku me katër karrige, është modifikuar një pjesë e korridorit në hyrje të banesës si dhomë studimi ku janë vendosur biblioteka së bashku me katër karrige dhe një tavolinë pune, si dhe ndriçuesit përkatës në sallon dhe në dhomën e studimit;
- e) në vitin 2010 ka shpenzuar vlerën 400.000 lekë, pasi është mobiluar dhoma e gjumit e fëmijëve, në çdo element të saj, përfshirë edhe kondicionerin, perdet, ndriçuesin, etj.

Subjekti ka shpjeguar se shpenzimet e mobilimit janë mbuluar me të ardhurat e siguruar në vitet përkatëse, kur edhe janë kryer këto shpenzime, nga pagat e saj dhe të ardhurat e të bashkëshortit.

Në lidhje me vlerat e mobilimit të apartamentit të shtrira në kohë, nga verifikimi i deklarimeve periodike vjetore, ka rezultuar se subjekti nuk i ka deklaruar, këto shuma në seksionin “ndryshimet e interesave private pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme” edhe pse këto vlera janë në shuma të konsiderueshme, të cilat duhet të ishin deklaruar.

Referuar shpjegimeve të subjektit, vlera e mobilimit të kryer, ndër vite, e konvertuar me kursin mesatar vjetor për çdo vit për periudhën 2006 – 2010 shkon në rreth 20.130 euro, ndërkohë ka rezultuar se këto mobilie dhe pajisje të përdorura janë shitur në shumën 18.000 euro në vitin 2012.

Nga hetimi administrativ ka rezultuar se apartamenti në Fier nuk është banuar nga momenti i shitjes për vite me radhë. Blerja e apartamentit dhe e mobilieve të përdorura me një çmim të konsiderueshëm, duke mos u përdorur për rreth 4 vjet, ngre dyshime për të gjithë procesin e shitjes.

¹⁰Së apartamentit në Fier në datën 6.12.2012, me blerësit I e D. B.

Në analizim të fakteve sa më sipër, çmimi i shitjes për mobiliet e përdorura rezulton i lartë, krahasuar me çmimin e blerjes sipas deklarimeve të subjektit, duke marrë në konsideratë dhe faktin e amortizimit të tyre.

1.8 Në lidhje me aktin e shitjes së pasurisë apartament në Fier

Subjekti ka deklaruar se të ardhurat e krijuara nga shitja e apartamentit në Fier, kanë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit në Tiranë.

Nga analizimi i akteve rezulton kontrata premtim-shitje (pasuri e paluajtshme) nr. ***, datë 6.12.2012, me palë shitëse në të ardhmen shtetasin M. S dhe palë blerëse në të ardhmen shtetasin I. B, të pasurisë apartament me sip. 83.3 m², në lagjen “* T” Fier.

Pala shitëse ka rënë dakord t’i shesë palës blerëse pasurinë apartament, si dhe orenditë shtëpiake që ndodhen brenda në të (mobiliet, pajisje hidrosanitare, etj.), kundrejt shumës së përgjithshme 73.000 euro. Vlera e shitjes së apartamentit, për të cilën palët kanë rënë dakord, është 55.000 euro dhe vlera e shitjes të sendeve/orendive shtëpiake që ndodhen në apartament është llogaritur në shumën 18.000 euro, pra, në total në shumën 73.000 euro.

Pala blerëse i ka paguar palës shitëse në ditën e lidhjes së kësaj kontrate shumën 68.000 euro. Likuidimi është bërë *cash* jashtë zyrës noteriale. Palët kanë rënë dakord që shuma e mbetur në vlerën 5.000 euro do të likuidohet nga pala blerëse brenda një viti duke filluar afati nga dita e nënshkrimit të kontratës.

Kjo pasuri është rivlerësuar në vitin 2013, në vlerën 7.700.000 lekë, ekuivalente me afërsisht 54.918 euro në vitin 2013.

Më pas, palët kanë nënshkruar kontratën e shitblerjes së apartamentit në Fier me nr. ***, datë 21.1.2016, me palë shitëse shtetasit M.S dhe Lindita Sinanaj dhe me palë blerëse shtetasin I. B. Vlera e apartamentit është 55.000 euro. Likuidimi i vlerës prej 55.000 euro është bërë sipas kushteve të vendosura në kontratën premtim-shitje të datës 6.12.2012 dhe sipas deklaratës noteriale të datës 17.1.2014.

1.9 Faktet e rezultuara gjatë hetimit

i) Komisioni ka hetuar në lidhje me çmimin e shitjes së apartamentit, i konvertuar në lekë vlera e apartamentit me sip 83 m², është 92.252 lekë/m², pa përfshirë vlerën e mobilimit, referuar çmimit të EKB-së, për vitin 2012, rezulton se çmimi i referencës në tregun e lirë për shitjen e apartamenteve në Fier shkon në 58.500 lekë/m². Referuar akteve të dosjes dhe përgjigjes së ASHK-së rezulton se apartamenti i shitur nga shtetasi M.S, ndodhet në një pallat të ndërtuar që në vitin 1987¹¹.

- Nga hetimi i kryer rezulton se subjekti e ka shitur këtë pasuri shumë më tepër se çmimi i referencës sipas EKB-së.

ii) Sikurse u trajtua më sipër, pajisjet/mobiliet e përdorura të apartamentit në Fier, janë deklaruar të shitura në shumën 18.000 euro, në vitin 2012, ndërkohë që mobilimi i apartamentit në Tiranë, është deklaruar në shumën 900.000 lekë.

¹¹Referuar kontratës së privatizimit që shitësi i mëparshëm kishte nënshkruar me Ndërmarrjen Komunale të Banësve.

iii) Referuar fakteve të rezultuara gjatë hetimit, blerësit e apartamentit në Fier, I dhe D.B, janë persona me lidhje familjare të afërt me subjektin e rivlerësimit, konkretisht, D.B është motra e bashkëshortit të subjektit, banuese në fshatin Mbyet, Fier.

Nisur nga ky fakt, Komisioni i ka kërkuar¹² subjektit informacion dhe dokumentacion mbi burimet e ligjshme që kanë shërbyer për blerjen e këtij apartamenti nga shtetasit I dhe D. B. Subjekti, në përgjigjet e pyetësorit¹³, ka shpjeguar, ndër të tjera, se: “... shtetasi I. B, është kunati im. Ky i fundit (I) na ka kërkuar që banesën që ne kishim në qytetin e Fierit ta blinte për vëllain e tij, të quajtur A.B, i cili prej shumë vitesh ishte emigrant në Greqi së bashku me familjen e tij. Të ardhurat e siguruara nga puna e tij, kursime ndër vite, A ja kishte lënë në administrim e ruajtje prindërve të cilët jetonin në fshatin Mbyet, Fier, ku banon edhe shtetasi I. B me familjen e tij. Në kushtet kur A nuk kishte banesë të tij në Shqipëri dhe prindërit kishin merak të mbanin në shtëpi shuma të konsiderueshme lekësh, kërkuan të blinin shtëpinë tonë, duke qenë se kunati kishte qenë shpesh herë tek ne dhe ishte në dijeni të vendndodhjes së favorshme të banesës dhe gjithë investimeve që ne kishim bërë në këtë banesë, ndaj kishin pëlqim për banesën. Në kushtet kur A nuk kishte domosdoshmëri lirim të menjëhershëm të banesës, pasi ishte në Greqi emigrant, si dhe kur çmimi i ofruar ishte për ne i kënaqshëm, duke pasur parasysh edhe marrëdhënien miqësore me palën blerëse dhe duke na interesuar të likujdonim huanë e marrë, pavarësisht se nuk kishim nevojë urgjente, kemi rënë dakort të shisnim shtëpinë, fillimisht duke përpiluar kontratën paraprake në të cilën parashikua që dorëzimi i banesës dhe likuidimi total i shumës të bëhej pas një viti nga lidhja e kontratës paraprake, pra në muajin dhjetor 2013. Në këto rrethana, rreth muajit tetor 2012, kemi kryer edhe rivlerësimin e banesës në ZVRPP Fier, me qëllim që të lidhej kontrata e shitjes me palën blerëse...

Në momentin e lidhjes së kontratës, kunati, I. B së bashku me babanë e tij kërkuan që kontrata paraprake të lidhej në emër të I, pasi i vëllai ishte në Greqi, por dhe për shkaqe të tjera.... Në këto rrethana, në fillim të muajit dhjetor të vitit 2012, ne kemi lidhur kontratën paraprake të shitjes me shtetasin I.B për banesën në fjalë dhe kemi marrë prej tij shumën për të cilën kishim rënë në marrveshje për t'u shlyer paraprakisht, sikurse përcaktohet edhe në kontratë. Ndërkohë, deri në muajin dhjetor të vitit 2013, banesa në qytetin e Fierit ka qenë në posedimin tonë. Ne banonim në qytetin e Tiranës, por në ditë të veçanta, kur për nevoja pune nuk na mundësohej kthimi në Tiranë, unë ose bashkëshorti im, qëndronim në Fier në ish banesën tonë. Në kushtet kur banesa ishte ende në emrin tonë dhe përdorej prej nesh, edhe detyrimet për konsumin e energjisë dhe të ujit janë paguar prej meje. Pikërisht për këtë shkak është autorizuar BKT-ja prej meje për pagesën edhe të faturave të banesës në fjalë nga gjendja ime e llogarisë bankare, sikurse kam shpjeguar edhe më parë”.

¹²Me pyetësorin e datës 16.4.2021.

¹³Ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 26.4.2021.

Në vijim të shpjegimeve, subjekti ka depozituar dokumentacion¹⁴ mbi të ardhurat e z. I. B. Nga hetimi i kryer rezulton se në familjen¹⁵ B të përbërë nga 7 anëtar, i vetmi person, i cili figuron i punësuar, ka qenë z. I. B, pranë shoqërisë “A” sh. a. Gjithashtu, ka rezultuar se z. I. B ka pasur një kontratë qiraje me shoqërinë “A” sh. a. për një sipërfaqe toke, me të ardhura vjetore në shumën 1.500.000 lekë/vit.

- Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar për të ardhurat e blerësit të apartamentit në Fier, duket se familja B nuk ka pasur burime të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie.

iv) Në lidhje me shpjegimet se ky apartament është blerë *de facto* nga shtetasi A. B., subjekti nuk ka depozituar asnjë provë për të provuar këtë fakt, asnjë dokumentacion provues mbi të ardhurat e ligjshme për një vlerësim të situatës financiare, si dhe mundësitë e këtij shtetasi për të blerë apartamentin në vlerën 73.000 euro.

- Në lidhje me mundësitë financiare të blerësit A. B. të deklaruar gjatë hetimit, rezultoi mungesë dokumentacioni provues në lidhje me mundësitë financiare të tij.

v) Pagesat për blerjen e apartamentit nga shtetasi I dhe D.B, nuk mbështeten me ndonjë dokument apo provë indirekte, ku të tregohet mundësia financiare e blerësve.

vi) Blerësit e apartamentit sipas akteve të shitjes, rezultonin ende banorë në fshatin Mbyet, Fier, së bashku me 5 fëmijët e tyre dhe jo në Fier, ku ndodhet apartamenti i blerë.

vii) Nga subjekti nuk është depozituar asnjë provë që vërteton pretendimin e tij se prona mund të jetë blerë në emër të një pale të tretë, shtetasi A. B.

viii) Nga verifikimi i të dhënave bankare ka rezultuar se subjekti pas shitjes së apartamentit në Fier, ka vijuar likuidimin e detyrimeve me OSHEE-në, për faturat e shërbimit të furnizimit me energji për këtë apartament, nga llogaria në BKT, deri sa kjo llogari bankare është mbyllur në gusht të viti 2016.

Referuar pagesave të OSHEE-së, nuk duket se ka konsum të energjisë për apartamentin në Tiranë deri në dhjetor të vitit 2013, ndërsa apartamenti në Fier ka konsum deri në janar të vitit 2014. Faktet ndryshojnë në janar të vitit 2014, kur fillon konsumi në apartamentin në Tiranë dhe në apartamentin në Fierit ndërpritet deri në gusht të vitit 2016, sipas të dhënave të fundit në dispozicion.

Të gjitha faktet listuar sa më sipër, ngrenë dyshimin se shitja e kësaj pasurie mund të jetë fiktive, për të justifikuar blerjen e pasurisë apartament në Tiranë.

1.10 Konstatime të Komisionit

Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se:

- a. nga analiza e kryer ka rezultuar pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme në shumën 2.018.362 lekë, për blerjen e apartamentit në Fier në vitin 2000;

¹⁴Lidhur me dokumentacionin provues për burimet financiare të palës blerëse, në mbështetje të shpjegimeve të saj, ka depozituar këto akte: deklaratë noteriale nr. *** rep., datë 21.4.2021, lëshuar nga shtetasi I.B; deklaratë noteriale nr. *** rep., datë 21.4.2021, lëshuar nga shtetasi A.B; vërtetim nga Kryeplaku i fshatit Mbyet, lëshuar për shtetasin A. B; vërtetim nga Kryeplaku i fshatit Mbyet, lëshuar për shtetasin I. B; kontratë shitblerjeje nr.** rep., datë 21.1.2005; kontratë qiraje nr. *** rep., datë 4.6.2010; gjendja e llogarisë bankare në emër të shtetasi I.B; librezë pune që i përket shtetasi I. B; vërtetim nr. ** pro., datë 24.3.2021, nga Njësia Administrative P; Akt i Marrjes së Tokës në Pronësi lëshuar në emër të I.B.

¹⁵Shtetasi I dhe D. B kanë 5 fëmijë.

- b. çmimi i shitjes së apartamentit në Fier, duket shumë më i lartë, krahasuar me çmimin e referencës sipas EKB-së, në momentin e shitjes;
- c. çmimi i shitjes së mobilimit të apartamentit në Fier duket shumë i lartë, krahasuar me vlerën e deklaruar për mobilimin e apartamentit në Tiranë;
- d. blerësit e apartamentit në Fier, kanë mungesë burimesh të ligjshme dhe, gjithashtu, dhe për pretendimin se blerësit këtë pasuri e kanë blerë për shtetasin A. B. as për këtë pretendim nuk u depozitua dokument provues apo provë tjetër indirekte;
- e. apartamenti në Fier duket si pasuri e fshehur e subjektit.

Në lidhje me konstatimet sa më sipër, për këtë pasuri subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në pikën 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

1.11 Qëndrimi i subjektit

Pas kalimit të barrës së provës, subjekti, në prapësimet e depozituar në datën 21.6.2021, ka pretenduar se:

i) Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë së tjetërsuar, subjekti ka shpjeguar se në deklaratën e parë të pasurisë të vitit 2003, ka deklaruar se zotëron ¼ e kësaj pasurie bazuar në kontributin personal që ka pasur në këtë pasuri.

Me kursime familjare ka nënkuptuar se përveç kursimeve nga të ardhurat nga pagat dhe shpërblimet nga puna e saj dhe e bashkëshortit, në mbledhjen e të ardhurave të nevojshme për blerjen e apartamentit kanë kontribuar edhe prindërit e bashkëshortit, Sh dhe H.S, në masën rreth 600.000 lekë. Prindërit e bashkëshortit, në momentin e blerjes së banesës kanë qenë në gjendjen civile me subjektin, pavarësisht faktit se nuk kanë jetuar me ta. Pikërisht, për këtë shkak janë deklaruar edhe të ardhurat dhe pasuritë e tyre në deklaratën për herë të parë të vitit 2003.

Prindërit e bashkëshortit kanë realizuar këto të ardhura nga veprimtaria bujqësore dhe blegtorale e ushtruar prej tyre, kjo e mbështetur edhe në deklaratimet e subjektit për tokën bujqësore të përfitur me ligjin nr. 7501/1991, ku kanë përfitur 17.470 m² tokë¹⁶. Duke qenë se familja e bashkëshortit ka jetuar gjithmonë në fshat ata janë marrë me bujqësi dhe kanë realizuar të ardhura nga kjo tokë. Fakti i pronësisë mbi sipërfaqen e tokës në fjalë është deklaruar prej saj në deklaratën e vitit 2003, madje në rubrikën “të ardhura vjetore në milion/lekë” është shënuar “0,5”. Pra, konstatimi se këto të ardhura nuk janë deklaruar nuk qëndron.

Shuma e dhënë nga prindërit e bashkëshortit nuk është provuar mbi bazën e ndonjë dokumenti, pasi janë në marrëdhënie të ngushtë familjare dhe nuk ka qenë e nevojshme përpilimi i ndonjë akti të posaçëm. Këto shuma janë dhënë në periudhën kur është blerë pasuria, në prill të vitit 2000, me burim të ardhurat e përfituara nga toka bujqësore për periudhën 1992 – 2000.

Aktiviteti bujqësor për periudhën në fjalë nuk ishte aktivitet që mund të regjistrohej, prandaj edhe është e pamundur aktualisht të evidentohet saktësisht shuma konkrete e të ardhurave të realizuara.

¹⁶Mbi bazën e AMTP-së nr. ***, lëshuar në emër të shtetasit Sh.S (vjehtëri i subjektit).

ii) Në lidhje me shumën 1.950.000 lekë, dhënë nga prindërit e subjektit, e cila ka buruar nga shitja e apartamentit në Fier, subjekti ka pretenduar se pavarësisht faktit se kontrata e shitblerjes është formalizuar në datën 22.6.2000, çmimi i shitjes është paguar nga blerësit në muajin prill. Kjo marrëveshje u bë me blerësin, pasi, për shkak të nevojës që subjekti kishte për blerjen e banesës 2+1 në lagjen “* T” Fier, kjo shumë do t’u paguhej më parë dhe familja e subjektit do të qëndronte në banesë edhe për dy muaj të tjerë, derisa të përfundonin kryerjen e disa punimeve të domosdoshme në banesën e re. Pikërisht, për këtë shkak edhe kontrata e shitjes së banesës është lidhur pas lirit dhe dorëzimit të saj, në fund të qershorit të vitit 2000. Subjekti ka theksuar se shitja e banesës formalisht është bërë nga prindërit e saj, në kushtet kur pronësia mbi banesën figuronte në emër të tyre, por në fakt kjo banesë i ishte dhuruar asaj që në momentin që ishte blerë, si dhe është zotëruar prej saj, pasi prindërit kishin banesë tjetër, e cila ndodhej në lagjen “** T”, Fier, e përfituar nga privatizimi dhe për të cilën subjekti ka dhënë shpjegimet përkatëse. Të ardhurat e siguruar nga shitja e kësaj banese në shumën 1.950.000 lekë i janë dhënë subjektit edhe në formën e kontributit për blerjen e banesës së re, por edhe në këmbim të pjesës takuese, pasi ishte madhore në momentin e privatizimit dhe i takonte 1/3 e kësaj pasurie.

Subjekti ka argumentuar se në momentin e dhënies së kësaj shume, midis saj dhe prindërve nuk është mbajtur ndonjë akt formal shkresor për të dokumentuar këtë veprim, për shkak të marrëdhënies shumë të ngushtë familjare, prandaj fakti i dhënies së kësaj shume mund të provohet vetëm nëpërmjet deklarimeve të saj dhe të prindërve.

Subjekti kërkoi nga Komisioni që të marrë në konsideratë dhurimet e prindërve të saj dhe të prindërve të bashkëshortit, në shumat 1.950.000 lekë dhe 600.000 lekë, për blerjen e pasurisë. Për këtë ka depozituar edhe dy deklaratat noteriale të nënshkruara në qershor të vitit 2021, ku prindërit respektivë kanë deklaruar se i kanë dhënë shumat përkatëse sipas deklarimeve të saj.

iii) Në lidhje me mosdeklarimin e shtesës, subjekti ka shpjeguar se nuk është deklaruar prej saj në deklaratat vjetore, pasi në fakt nuk ka ndryshuar sipërfaqja ndërtimore e banesës, por sipërfaqja e ballkonit ekzistues të banesës i është përshtatur ambienteve të brendshme të banesës, duke u mbyllur, konkretisht është zgjeruar sipërfaqja e aneksit dhe guzhinës, por brenda sipërfaqes ekzistuese të banesës. Investimi i mësipërm është kryer me kursimet nga të ardhurat familjare të deklaruara dhe vlera e investimit ka qenë rreth 200.000 lekë. Ky fakt provohet edhe nga raporti që i është bërë pasurisë përpara se të shitej në vitin 2013, ku sipërfaqja e pasurisë paraqitet e pa ndryshuar me 83.3 m².

Në kushtet kur nuk ka ndryshim të llojit të pasurisë, e cila ka shërbyer gjatë gjithë kohës si banesë, si dhe nuk ka ndryshuar sipërfaqja ndërtimore e banesës, subjekti ka shpjeguar se nuk ka pasur detyrimin për të deklaruar në deklarin periodik vjetor të vitit 2008, investimin e kryer.

iv) Në lidhje me mosdeklarimin e shpenzimeve për mobilim, subjekti ka shpjeguar se neni 4 i ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, detyron vetëm deklarimin e pasurive të paluajtshme, pasurive të luajtshme, por që janë të regjistrueshme në regjistrat publikë, si dhe sendeve me vlerë të veçantë mbi 5.000 USD. Për rrjedhojë, edhe për sa i përket deklarimeve periodike vjetore, zyrtari publik kishte detyrimin për deklarimin e atyre shpenzimeve që passillnin ndryshime (shtesa apo pakësime) pikërisht për këto pasuri. Ndërkohë, sendet që përbëjnë mobilimin e

banesës asnjëherë nuk kanë qenë të regjistrueshme në regjistrat publikë, prandaj nuk ka qenë detyrim deklarimi i tyre. Gjithashtu, pavarësisht vlerës tërësore të mobilimit, ndër vite, asnjë prej orendive nuk përbënte send të veçantë me vlerë mbi 5.000 USD, prandaj nuk është deklaruar prej subjektit.

v) Në lidhje me vlerën e shitjes së orendive shtëpiake, subjekti ka deklaruar se norma e amortizimit të pajisjeve, sipas konstatimeve të Komisionit, nuk gjen zbatim në rastin e përcaktimit të vlerës së shitjes së orendive shtëpiake, çmimi i të cilave i nënshtrohet plotësisht rregullave të tregut të lirë.

Në mbështetje të pretendimeve, subjekti ka depozituar listën e çmimeve të mobilierisë ku ka bërë blerjet për periudhën 2007 – 2010, si dhe aktin e vlerësimit të ekspertëve vlerësues dhe arkitektit, të cilët kanë përcaktuar vlerën e mobilimit të banesës në raport me çmimin e banesës.

Në aktin në fjalë, ekspertët, duke konkluduar mbi vlerat në tregun e lirë, kanë studiuar çmimet e tregut lidhur me shitjen dhe dhënien me qira të banesave, duke bërë diferencat midis banesave të mobiluara dhe banesave të pamobiluara. Nga ky studim rezulton se vlera e mobilimit zë rreth 32% të vlerës së banesës.

Për sa më sipër, subjekti ka pretenduar se konkluzioni që çmimi i shitjes së pajisjeve duket jo real dhe fiktiv është i pabazuar në analizën e rrethanave të faktit dhe të ligjit, të parashtruara më sipër.

vi) Në lidhje me shitjen e apartamentit në Fier (te të afërm të bashkëshortit), subjekti ka mbajtur të njëjtin qëndrim si gjatë hetimit. Subjekti ka pretendimin se referuar pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, blerësit e pasurisë në Fier, nuk kanë detyrimin që të provojnë burimet e ligjshme që kanë shërbyer për blerjen e këtij apartamenti, pasi nuk kategorizohen si persona të lidhur apo të tjerë të lidhur që parashikon kjo dispozitë (dhurues/huadhënës/huamarrës).

Për sa i përket konstatimit të Komisionit se çmimi i shitjes së pasurisë krahasuar me çmimin e referencës është më i lartë, subjekti ka pretenduar se krahasimi që ka bërë Komisioni me çmimin e referencës për të përcaktuar çmimin e shitjes së apartamentit në tregun e lirë është i pabazuar. Çmimi i referencës bazuar në të dhënat e EKB-së përcakton koston mesatare vjetore të ndërtimit të banesave, në kuadër të programeve sociale për shtresat në nevojë. Kjo për faktin se këto çmime janë përcaktuar për ndërtimet e shtëpive për strehimin e familjeve dhe të individëve, që nuk janë në gjendje ekonomike dhe sociale të përballojnë ofertën e tregut të lirë të banesave apo atë të kredive hipotekare.

Në kundërshtim të qëndrimit të Komisionit, subjekti ka pretenduar se nëse i referohemi metodologjisë për vlerësimin e pronave të paluajtshme, metodologji e cila është miratuar edhe me VKM-në nr. 658, datë 26.9.2012, rezulton se si çmim mesatar llogaritet vlera mesatare e të gjitha transaksioneve për një lloj prone, në të njëjtën zonë.

Gjithashtu, subjekti pretendon se çmimi i shitjes së apartamentit është në vlerën reale të tregut për këtë lloj pasuri, duke e mbështetur këtë qëndrim në faktin se rivlerësimi i pasurisë në vitin e shitjes është në të njëjtën shumë me çmimin e shitjes së saj.

vii) Në lidhje me analizën financiare të kryer nga Komisioni, subjekti ka pretenduar se nuk janë përfshirë në analizë, të ardhurat e siguruar nga bashkëshorti nga punësimi në shoqërinë “A”, për periudhën 1994 – 2000, në shumën 115.585 lekë.

Subjekti ka pretenduar se shpenzimet e jetesës për periudhën 1994 – 2000, Komisioni nuk duhet t'i llogarisë me 66% të të ardhurave nga pagat (standard i vendosur nga Kolegji në vendimin për subjektin e rivlerësimit N. K.), por duke iu referuar të dhënave për frymë bazuar në të dhëna që referon INSTAT.

1.12 Vlerësimi i Komisionit

Pas shqyrtimit të shpjegimeve të dhëna nga subjekti dhe akteve të depozituara prej saj, Komisioni konstaton mospërputhje deklarimesh, në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë apartament në Fier, pasi burimet e deklaruar në deklaratën *Vetting*, nuk përputhen me burimet e deklaruar gjatë hetimit.

Për mungesën e burimeve të ligjshme për blerjen e apartamentit në Fier, subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit, si dhe nuk provoi me dokumentacion provues shumat e dhëna si nga prindërit e bashkëshortit ashtu dhe nga prindërit e saj.

Subjekti nuk arriti që të provonte burimet e ligjshme në shumën 600.000 lekë të dhuruar nga prindërit e bashkëshortit, të krijuar me të ardhurat nga bujqësia.

Subjekti, gjithashtu, nuk arriti të provonte burimet e ligjshme për shumën 1.950.000 lekë.

Deklarimet e subjektit lidhur me blerësit e apartamentit në Fier, shtetasit I e D.B dhe më pas u deklarua se apartamenti u ble për shtetasin me inicialet A. B., me të ardhurat e tij nga emigracioni, ngritën dyshimet e arsyeshme për Komisionin, për vetë dinamikën që ka pasur ky transaksion. Trupi gjykues, konsideroi se blerësit e pasurisë apartament në Fier (I e D.B, motra dhe kunati i bashkëshortit), janë “persona të tjerë të lidhur”, referuar pikës 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/201614, ku parashikohet se: *“Një person fizik ose juridik të konsiderohet si ‘person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit’, duhet që të provohet një lidhje interesi mes tyre, e cila duhet të rrjedhë nga: (i) një interes pasuror; ose (ii) çdo marrëdhënie tjetër biznesi”*.

Komisioni në vlerësimin tërësor të situatës, nisur nga faktet se: (i) apartamenti u shit, ndërkohë që vazhdonte të përdorej nga subjekti edhe një vit më pas; (ii) ky apartament nuk rezulton të jetë përdorur nga blerësi, ndërkohë që subjekti ka vijuar të paguajë faturat e furnizimit me energji elektrike; (iii) blerësi rezultoi në pamundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie, ndërkohë që gjatë hetimit subjekti shpjegoi se ky apartament *de fakto*, është blerë dhe paguar nga shtetasi A. B.; (iv) çmimi i shitjes së apartamentit rezultoi më i lartë se sa çmimi i referencës sipas EKB-së; (v) blerësi ka paguar për pajisjet dhe mobiliet e përdorura një vlerë të lartë, ndërkohë apartamenti nuk banohet prej tij; si dhe (vi) të ardhurat e krijuara nga shitja e apartamentit në Fier, janë deklaruar nga subjekti si burim për blerjen e shtëpisë apartament në Tiranë.

Të gjithë elementët e mësipërm ngrenë dyshime të arsyeshme që pasuria apartament në Fier mund të jetë pasuri e subjektit të rivlerësimit dhe shitja e kësaj pasurie tek persona të afërt familjarë, është fiktive për të justifikuar blerjen e një pasurie tjetër.

Në lidhje me pretendimet e subjektit se Komisioni nuk ka përfshirë në analizën financiare të ardhurat e siguruar nga bashkëshorti nga punësimi në shoqërinë “A” sh. a., për periudhën 1994 – 2000, në shumën 115.585 lekë, ky pretendim nuk qëndron, pasi, për vitet në fjalë, Komisioni është bazuar në një dokument të depozituar prej saj, ku janë saktësuara pagat *neto*

të bashkëshortit me shumat respektive të reflektuara në analizën e Komisionit, sipas formularëve të ISSh-së.

Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se shpenzimet e jetesës, për periudhën 1994 – 2000, Komisioni nuk duhet t'i llogarisë me 66% të të ardhurave nga pagat, por duke iu referuar të dhënave për frymë bazuar në të dhënat që referon INSTAT. Këto pretendime nuk mund të merren në konsideratë nga Komisioni referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit, sipas vendim nr. 30/2018 (JR), datë 26.7.2019, ku është parashikuar se: *“Shpenzimet e jetesës deri në vitin 1999, janë llogaritur në masën 66% të të ardhurave”*. Mbi këtë arsytim është bërë analiza financiare nga Njësia e Shërbimit Ligjor dhe, për pasojë, pretendimet e subjektit nuk merren për bazë dhe analiza financiare nuk pësoi ndryshime mbi këtë pretendim.

Trupi gjykues, pasi analizoi të gjitha faktet dhe provat e administruara, shpjegimet e subjektit në prapësime dhe në seancë, lidhur me pasurinë apartament në Fier, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh të ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurisë në datën 26.4.2000, në përputhje me pikën 3, të neni D, të Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, në kuptim të kësaj dispozite kushtetuese dhe neneve 30 dhe 33, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit rezultoi të jetë në kushtet e burimeve të pamjaftueshme për të justifikuar blerjen e apartamentit në Fier. Gjithashtu, nuk arriti të provojë shitjen reale të kësaj pasurie.

2. Apartament me sip. 111m², në Sauk, Tiranë

Vlera e deklaruar: 8.500.000 lekë.

Pjesa në përqindje: pasuri e pandarë.

Burimi i krijimit: nga shitja e apartamentit 2+1 në Fier, në shumën 55.000 euro banesa + 18.000 euro mobilimi.

Mënyra e fitimit: me kontratën nr. ***, datë 5.6.2012.

ILDKPKI-ja, për këtë pasuri, ka konstatuar se:

- mungon dokumentacioni justifikues ligjor, lidhur me burimin financiar të shtetasit A.C për dhënien e shumën 80.000 euro hua bashkëshortit të subjektit, çka e bën deklarin e rremë; dhe
- evidentohet se të gjitha transaksionet e shitblerjeve të pasurive të paluajtshme janë bërë në *cash* dhe jo nëpërmjet sistemit bankar, gjithashtu, e njëjta situatë paraqitet edhe me marrjen dhe kthimin e shumës 80.000 euro hua, çka krijon dyshime lidhur me këto transaksione.

2.1 Hetimi i kryer nga Komisioni

ASHK-ja Drejtoria Vendore¹⁷ ka konfirmuar se shtetasi M.Sh.S, ka të regjistruar pasurinë nr. ***, vol. **, f. ***, z. k. ***, të llojit apartament me sip. 111m², bashkëlidhur është kontrata e shitblerjes (pasuri e paluajtshme) nr. ***, datë 8.3.2012, me palë shitëse shoqërinë “C ***” sh.p.k. S, të pasurisë apartament me sip. 111m², në shumën 8.500.000 lekë. Kjo vlerë është kryer tërësisht prej blerësit përpara nënshkrimit të kësaj kontrate shitjeje.

¹⁷Me shkresën nr. *** prot., datë 21.10.2019.

OSHEE-ja¹⁸ ka informuar se referuar sistemit të faturimit në emër të shtetasit M.Sh.S, identifikohet një abonent me kontratë furnizimi në instancën e Tiranës, me adresë pranë Kopshtit Zoologjik.

UKT-ja¹⁹ ka informuar se shtetasi M.Sh.S disponon kontratë për furnizimin me ujë, për objektin me adresë rruga “K.Z”, Tiranë, me status aktiv në kategorinë e konsumatorëve familjarë.

2.2 Burimi i krijimit

Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie:

- Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar si burim apartamentin e shitur në Fier, në shumën 55.000 euro banesa + 18.000 euro mobilimi.
- Në DPV-në e vitit 2012, subjekti ka deklaruar se ka shitur pasurinë 2+1, në Fier, në shumën 55.000 euro banesa + 18.000 euro orenditë shtëpiake, në total 73.000 euro, me kontratën premtim-shitje nr. ***, datë 6.12.2012, si dhe ka blerë me kontratën e shitjes nr. ***, datë 8.3.2012, në shumën 8.500.000 lekë, pasurinë apartament në Tiranë (2+1).

Në DPV-në e vitit 2012, në seksionin e të “dhënave konfidenciale”, subjekti ka deklaruar se, duke qenë se apartamenti në Fier nuk ishte shitur ende, për blerjen e banesës në Sauk, në janar të vitit 2012, bashkëshorti ka marrë hua në shumën prej 80.000 euro, nga shtetasi A. C²⁰, i cili është dhe i afërmi i saj (daja), me kontratën e huas nr. ***, datë 17.1.2012.

2.3 Shpjegimet e subjektit, në lidhje me huan në shumë 80.000 euro

Subjekti ka deklaruar se shumën prej 80.000 euro, fizikisht e ka marrë nga shtetasi U.C (djali i dajës). Pas shitjes së apartamentit në Fier, në dhjetor të vitit 2012, kjo shumë e marrë hua i është shlyer totalisht, por në pamundësi për t’ia kthyer shtetasit A. C, pasi ishte rezident në SHBA, kjo shumë i është kthyer nipit të tij U.C, i cili është dhe personi që në fakt i ka administruar këto të holla, para se të merreshin hua nga subjekti. Për këtë fakt, në pamundësi për të marrë një konfirmim nga shtetasi A. C, për shkak të vendndodhjes së tij, subjekti ka bashkëlidhur një deklaratë lëshuar nga shtetasi U.C.

- ✓ Nga verifikimi i deklarimeve, si në deklaratën *Vetting ashtu* dhe në deklaratën periodik vjetor, konstatohet se subjekti ka deklaruar saktë pasurinë, burimin e krijimit, huamarrjen dhe kthimit e saj.

2.4 Për ndonjë rast konflikti interesi, Komisioni ka kërkuar informacion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, në lidhje me shtetasit e sipërcituar, si dhe për të gjithë personat fizikë dhe juridikë të cilët gjatë hetimit kanë rezultuar palë kontraktore me subjektin e rivlerësimit.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier²¹, ka vënë në dispozicion të Komisionit, listën e proceseve gjyqësore, që janë shqyrtuar pranë kësaj gjykate, me personat sipas listës së kërkuar nga Komisioni.

¹⁸Me shkresën nr. *** prot., datë 15.10.2019.

¹⁹Me shkresën nr. K-*** prot., datë 11.10.2019.

²⁰Nga verifikimi në sistemin *TIMS*, rezulton se ky shtetas, në datën e nënshkrimit të kontratës së huas ka rezultuar në Shqipëri.

²¹Me shkresën nr. *** prot., datë 7.4.2021.

Nga përgjigja, rezulton se subjekti nuk ka shqyrtuar ndonjë çështje me palë ndërgjyqëse personat me të cilën është përfshirë në marrëdhënie personale kontraktore.

Gjykata e Administrative e Apelit Tiranë²², ka vënë në dispozicion të Komisionit, listën e proceseve gjyqësore, që janë shqyrtuar pranë kësaj gjykate, me personat sipas listës së kërkuar nga Komisioni.

- ✓ **Nga përgjigjet e ardhura ka rezultuar se subjekti nuk ka shqyrtuar ndonjë çështje me palë ndërgjyqëse personat me të cilën është përfshirë në marrëdhënie personale kontraktore.**

2.5 Analiza e fakteve

Nga aktet e dosjes rezulton se subjekti ka nënshkruar një kontratë shitblerjeje në datën 8.3.2012, me palë shitëse shoqërinë “C *” sh.p.k., për blerjen e apartamentit me sip. 111m², në Sauk, Tiranë, nr. pasurie ***, vol. **, f. ***, në shumën 8.500.000 lekë. Kjo pagesë është kryer tërësisht prej blerësit përpara nënshkrimit të kësaj kontrate shitjeje.

Referuar deklarameteve të subjektit, si dhe akteve të administruar, ka rezultuar se z.M.S ka nënshkruar një kontratë huadhënieje nr. ***, datë 17.1.2012, me shtetasin A. C, për marrjen nga z. M.S të një huaje në shumën 80.000 euro. Huadhënësi A.C deklaron se i ka dorëzuar huamarrësit M.S shumën 80.000 euro, në datën 17.1.2012. Huamarrësi M.S deklaron se e ka marrë në dorëzim shumën 80.000 euro nga huadhënësi në datën 17.1.2012, me afat 10-vjeçar. Z. A.C deklaron se këtë shumë ua kishte dhënë në huapërdorje njerëzve të afërm të familjes së tij përpara disa vjetësh dhe kjo shumë i është kthyer në këtë periudhë.

Nga aktet e administruara nuk ka asnjë dokument, ku të provohet marrja e huas apo pagesa e kryer në favor të shitësit si mandatpagesë, apo transfertë bankare për blerjen e pasurisë.

Sipas akteve rezulton si huadhënës shtetasi A.C, me të cilin është lidhur kontrata e huas.

Në dosjen e ILDKPKI-së ka rezultuar deklarata noteriale nr. **, datë 23.1.2013, nëpërmjet të cilës shtetasit M. S dhe U.C deklarojnë se: *“Shtetasi M.S deklaron se me kontratë huadhënieje, datë 17.1.2012, i kam marrë hua pa interes shtetasit A. C një shumë të hollash prej 80.000 euro për blerjen e apartamentit me vendndodhje në Tiranë. Meqenëse unë në datën 6.12.2012 realizova me z. I. B kontratën e premtimit të shitjes së pasurisë time në Fier kundrejt çmimit 73.000 euro, duke u likuiduar nga blerësi për këtë shitje në vlerën prej 68.000 euro në mënyrë të njëanshme dhe me pëlqimin e palës huadhënëse A. C e revokoj kontratën e huas, duke i kthyer A.C të gjithë shumën e marrë hua në masën prej 80.000 euro. Meqenëse jemi brenda rrethit familjar, pasi huadhënësi është daja i bashkëshortes sime Lindita Sinanaj, por dhe për faktin që huadhënësi nuk ndodhet në Shqipëri, unë dhe me miratimin e tij këtë hua ja dorëzoj nipit të tij U.C, i cili ka marrë miratimin e A. C për të marrë në dorëzim këtë shumë”.*

Gjithashtu, z. U.C, deklaron se: *“Me cilësinë e të besuarit dhe nipit të A.C ka marrë në dorëzim cash në dorë nga M. S shumën prej 80.000 euro (shlyerje huaje sipas kontratës së huas, datë 17.1.2012)”.*

²²Me shkresën nr. *** prot., datë 9.4.2021.

2.6 Hetimi për burimet e ligjshme të huas në shumën 80.000 euro

Komisioni i ka kërkuar subjektin që të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit për huan e marrë në vitin 2012, në përputhje me nenin 32/4, të ligjit nr. 84/2016, si dhe të deklarojë burimin për shlyerjen e plotë të kësaj huaje.

Subjekti në përgjigje²³ ka paraqitur tri akte:

- Kontratë huadhënie nr. ***, datë 17.1.2012, e lidhur midis z. A.C në cilësinë e huadhënësit dhe z. M.S në cilësinë e huamarrësit. Objekti i kësaj kontrate është marrja e një huaje në shumën 80.000 euro.
- Deklaratë noteriale nr. ***, datë 23.1.2013, e shtetasve M.S e U.C. Referuar këtij akti shtetasi M. S deklaron se: *“... revokon kontratën e huas nr. *** kol., datë 17.1.2012, duke i kthyer z. A. C të gjithë shumën e marrë hua në masën 80.000 euro. Meqenëse jemi brenda rrethit familjar, huadhënësi është daja i bashkëshortes Lindita Sinanaj, por edhe për faktin se huadhënësi nuk ndodhet në Shqipëri, unë edhe me miratimin e huadhënësit këtë huaja dorëzohet nipit të tij z. U.C, i cili ka miratimin e z. A.C për të marrë në dorëzim këtë shumë”*.
- Deklaratë noteriale nr. ***, datë 7.2.2015, e shtetasit U.C, i cili deklaron se: *“Në muajin janar të vitit 2012, shtetasi A.C është kthyer përkohësisht në Shqipëri për të vizituar të afërmit e tij. Në këtë periudhë prej meje i është kthyer shuma e marrë së bashku me kamatat, në shumën gjithsej 80.000 euro. Kjo për faktin se këtë shumë A.C ia ka dhënë hua për ta përdorur për nevoja të familjes së tij shtetasit M.S, i cili është gjithashtu i afërmi ynë. (bashkëshortja e tij Lindita Sinanaj, është vajza e motrës së A dhe njëherësh dhe vajza e hallës sime). Këtë shumë shtetasi M.S ma ka kthyer mua sërish në muajin dhjetor të vitit 2012 në pamundësi për t'ia kthyer vetë shtetasit A.C, i cili jeton në SHBA. Kjo shumë sërish përdoret prej meje në ushtrimin e aktivitetit tim privat”*.

Referuar të dhënave nga aktet e sipërcituara dhe deklarimeve të subjektit huaja prej 80.000 euro është marrë *cash* në janar të vitit 2012 dhe është kthyer në dhjetor të po të njëjtit vit. Shuma e huas i është dorëzuar subjektit nga shtetasit U.C dhe i është kthyer në *cash* nga bashkëshorti i subjektit, po këtij shtetasi. Subjekti ka shpjeguar se marrëdhënia faktike e huamarrjes ka qenë me shtetasin U.C, i cili është administrator i shoqërisë “A-C” sh.p.k. dhe ortak i kësaj shoqërie me 80% të kuotave dhe, për pasojë, ka pasur mundësitë financiare për dhënien e shumës në fjalë.

Lidhur me gjendjen financiare të huadhënësit A.C, subjekti ka shpjeguar se: *“Nuk disponon akte që provojnë të ardhurat e tij para vitit 1998, dhe është në pamundësi për të siguruar këtë dokumentacion, për shkak të faktit se ky shtetas jeton familjarisht prej vitit 1998 në SHBA, por edhe për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar dhe mosruajtjes së akteve që mund të provojnë sigurimin e të ardhurave prej tyre.*

*Lidhur me shlyerjen e kësaj huaje subjekti ka shpjeguar se nga realizimi i kontratës paraprake në muajin dhjetor të vitit 2012, për shitjen e banesës së ndodhur në lagjen “** T” në Fier, duke përfshirë edhe mobilimin e saj, kanë realizuar 68.000 euro të ardhura,*

²³Ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 14.1.2021.

të cilat kanë shkuar për shlyerjen e huas së marrë, po në muajin dhjetor të vitit 2012. Lidhur me huan, subjekti ka shpjeguar se nuk është konsumuar e gjitha prej tyre, pasi pas kryerjes së shpenzimeve për blerjen e banesës, garazhit dhe një pjesë të arredimit të banesës së re, ka mbetur e pa shpenzuar pjesa tjetër, e cila së bashku me kursimet nga të ardhurat e tjera të vitit (pagat dhe shpërblimet e deklaruara), ka shërbyer për shlyerjen e huas në muajin dhjetor të vitit 2012”.

Në lidhje me marrjen e huas, Komisioni ka konstatuar se:

- a. nuk ka asnjë provë direkte apo indirekte të transferimit të kësaj shume nga shtetasi A.C (huadhënësi real) te subjekti dhe/ose bashkëshorti;
- b. sipas deklaratës noteriale²⁴ të z. U.C, datë 7.2.2015, burimi i gjendjes *cash* të dhënë nga z. A.C për bashkëshortin e subjektit M.S, është shlyerja e një huaje të vjetër, nga viti 1998, që U i detyrohej A.C. Huaja u shlye me para në dorë (*cash*) në janar të vitit 2012 për z. A.C, i cili e përdori si burim për huan e dhënë M.S;
- c. deklarimi i paraqitur nga z. U.C në deklaratën noteriale, përputhet me kontratën e huas së datës 16.1.2012, por bie në kundërshtim me deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në pyetësor, ku deklaroi se bashkëshorti ka marrë hua *cash* prej tij.

2.7 Në lidhje me burimet e ligjshme të huadhënësit

Referuar kontratës së huas, për shumën prej 80.000 euro, huadhënësi A. C, ka deklaruar se: *“Shumën që do jepte hua ua kishte dhënë në huapërdorje njerëzve të afërm të familjes së tij përpara disa vitesh, dhe kjo shumë i është kthyer në këtë periudhë”.*

Bazuar në dokumentacionin e depozituar, subjekti nuk mundi të provojë burimet e ligjshme të dajës A.C, për dhënien e huas në shumën prej 80.000 euro, në janar të vitit 2012.

2.8 Në lidhje me burimet e ligjshme të shtetasit U.C

Nisur nga sa ka pretenduar subjekti se dorëzimi *cash* i shumës 80.000 euro është bërë nga shtetasi U.C, Komisioni hetoi në lidhje me burimet e ligjshme të shumës. Subjekti ka depozituar deklaratën noteriale nr. ***, datë 23.3.2021, të shtetasit U.C, i cili në cilësinë e administratorit dhe ortakut me 80% të aksioneve të shoqërisë “A-C” sh.p.k., ka deklaruar se fondet për të dhënë hua në shumën 80.000 euro në vitin 2012, janë tërhequr nga arka e shoqërisë.

Z. U.C ka deklaruar se arka e shoqërisë ka qenë në administrimin e tij prej vitesh, si dhe ka sqaruar se bazuar në të dhënat e bilancit të shoqërisë në fillim të vitit 2012, të dorëzuar në QKB dhe administratën tatimore, arka e shoqërisë ka pasur mjaftueshëm fonde për të kryer këtë transaksion, më saktësisht shumën prej 69.543.930 lekësh. Duke qenë se shumë është tërhequr

²⁴Shtetasi U.C ka deklaruar se: *“Shtetasi A.C është daja im dhe është larguar për në SHBA në vitin 1998. Në të njëjtin vit, përpara nisjes, unë kam marrë nga ky shtetas shumë 5.000.000 lekë të reja me një përqindje interesi 10% në vit. Kjo shumë është përdorur nga unë për aktivitetin tim privat. Në janar të vitit 2012, shtetasi A. C është kthyer përkohësisht në Shqipëri. Në këtë periudhë, shumë e marrë hua nga unë është kthyer së bashku me interesin në shumën 80.000 euro. Kjo për shkak të faktit se ai ia kishte dhënë hua këtë shumë që ta përdorte për nevojat familjare shtetasit M.S që është i afërmi ynë. Bashkëshortja e tij Lindita Sinanaj është vajza e motrës së A dhe, gjithashtu, vajza e tezes sime. M. S ma ka kthyer këtë shumë mua përsëri në dhjetor të vitit 2012, në pamundësi për t'ia kthyer atë shtetasit A.C, i cili jeton në SHBA. Kjo shumë ende përdoret nga unë për ushtrimin e aktivitetit privat”.*

në janar të vitit 2012, nga arka e shoqërisë dhe është arkëtuar në dhjetor të po atij viti, z. U.C ka argumentuar se ky transaksion nuk gjen pasqyrim në zërat e bilancit të vitit 2012.

Në Komision, për të mbështetur këtë argument, është depozituar dokumentacioni në vijim:

- gjendje të llogarisë bankare të shoqërisë “A-C” sh.p.k., për vitin 2012, në “Credins Bank”, “Societe Generale Albania” (sot OTP Bank) dhe në “Intesa Sanpaolo Bank”;
- pasqyrat financiare të shoqërisë (bilancet 2011-2012) të deklaruara në QKB dhe në tatime, ku vërtetohen gjendjet *cash* dhe bankat në muajt janar dhe dhjetor të vitit 2012;
- përmbledhje e llogarive bankare dhe gjendjen faktike të zërit “arkë” në bilancet e shoqërisë.

Referuar shpjegimeve të subjektit, por edhe akteve të administruara, rezulton se shtetasi U.C, është një nga 2 ortakët e shoqërisë “A-C” sh.p.k., me 80% të kapitalit themeltar, me objekt veprimtarie “shfrytëzim i mineralit te kromit, tregtimi brenda vendit me shumicë dhe eksporti me shumicë të mineralit të kromit, në fushën e punimeve me materiale plasëse dhe shpërthyes. Import eksport të lëndëve plasëse dhe shpërthyes për përdorim civil, studiues, projektues, etj.”.

DRT-ja Dibër²⁵ ka depozituar për shoqërinë “A-C” sh.p.k., për vitet 1998 – 2012, dokumentacionin: (i) bilancet e shoqërisë; (ii) fitimin e deklaruar për çdo vit; (iii) dividendin e shpërndarë për çdo vit; si dhe (iv) pagat e deklaruara për shtetasin U.C, për këtë periudhë.

Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar, ka rezultuar se përputhen të dhënat e deklaruara nga shtetasi U.C në deklaratën noteriale të datës 23.03.2021, me të dhënat e depozituara nga Tatimet Dibër.

Nga analizimi i dokumentacionit të shoqërisë “A-C” Sh.p.k., duket se në arkën e shoqërisë janë disponuar mjaftueshëm fonde për vitin 2012, për dhënien e huas në shumën 80.000 euro.

- Referuar akteve të depozituar nga subjekti, ka rezultuar se shtetasi U. C i ka dhënë shumën prej 80.000 euro, subjektit të rivlerësimit, si individ dhe jo në cilësinë e administratorit të shoqërisë apo ortakut në shoqërinë, ku zotëronte 80% të kuotave.

Në vijim të këtij arsyetimi, ky shtetas ka personalitet juridik të ndryshëm nga shoqëria tregtare që përfaqëson dhe nuk rezulton asnjë provë që të mund të ketë kryer transaksione të tilla në arkën e shoqërisë, apo të rezultojë se ka një autorizim nga shoqëria që përfaqëson për të kryer me likuiditetet e shoqërisë veprime në interes të palëve të treta.

Deklarata noteriale, datë 23.3.2021, referon “arkën” e shoqërisë si burim për pagesën e shumës 80.000 euro për shtetasin A.C, megjithatë, pavarësisht nga disponueshmëria e shumave *cash* të shoqërisë, ky pretendim nuk është mbështetur në asnjë dokument që të provojë se shtetasi U. C ka tërhequr shumën 80.000 euro nga arka. Nuk ka asnjë të dhënë që tregon se shoqëria i ka vënë në dispozicion administratorit një shumë kaq të konsiderueshme *cash*, si dhe asnjë e dhënë për këtë pagesë nuk gjendet në librin e shoqërisë.

Shpjegimi i shtetasit U.C për mungesën e dokumentimit të tërheqjes së kësaj shume nga arka e shoqërisë, se kjo shumë është kthyer brenda vitit dhe, për këtë arsye, nuk nevojitej një procedurë formale, është një praktikë jo e zakonshme financiare.

²⁵Me shkresën nr. *** prot., datë 25.3.2021.

Ky shpjegim, se shuma prej 80.000 euro do të rikthehej në arkën e shoqërisë brenda vitit 2012, nuk mbështet me parashikimin referuar kontratës së huas se shtetasi M.S duhet t'i kthente këto shuma brenda një afati 10-vjeçar dhe, për pasojë, z. U.C, nuk kishte se si të mos e pasqyronte në librat e shoqërisë këtë shumë të tërhequr nga arka.

Për këtë arsye, Komisioni ka konstatuar se shpjegimet e huadhënësit nuk janë bindëse dhe nuk provohet që këto shuma t'i jenë dhënë subjektit të rivlerësimit, si dhe të gjitha veprimet e kryera nga subjekti janë kryer *cash* (marrja dhe dhënia e huasë), si dhe nuk ka asnjë provë direkte apo indirekte të pagesave të ndërsjella.

2.9 Shlyerja e huas nga subjekti

Subjekti ka shpjeguar se me shitjen e apartamentit në Fier shuma e marrë është përdorur për shlyerjen e huas. Në lidhje me këtë transaksion, Komisioni konstatoi se:

- a. është e paqartë se përse shlyerja e huas i është bërë z. U.C nëse, siç deklarohej nga subjekti i rivlerësimit, "burimi" i huas është z. A.C;
- b. nuk ka asnjë provë që të vërtetojë se z. U.C kishte një detyrim prej 80.000 euro ndaj z. A.C, për shkak të një huaje të marrë në vitin 1998;
- c. nuk është paraqitur asnjë provë që vërteton se z. A.C ka autorizuar z. U.C të marrë shumën për shlyerjen e huas për llogari të tij;
- d. nuk ka asnjë provë ose mandat/dokument tjetër që të vërtetojë shlyerjen e huas *cash*, e cila bie në kundërshtim me natyrën formale të transaksionit të zgjedhur për të marrë hua me kontratë nr. ***, datë 17.1.2012, marrë në konsideratë edhe faktin që huaja është kthyer shumë më përpara se afati i dakordësuar;
- e. së fundmi (kjo ngre, gjithashtu, pikëpyetje rreth vërtetësisë së gjithë veprimit), shuma që i është kthyer U.C, për llogari të A.C, deklarohej ende e disponuar nga U.C;
- f. burimi i deklaruar për shlyerjen e huas janë të ardhurat nga shitja e apartamentit, i cili, siç shpjegohet më sipër, dyshohet të jetë një transaksion fiktiv.

Duke pasur parasysh sa më sipër, rezultoi e paprovuar dhënia e huasë, mundësitë financiare të ligjshme të huadhënësit shtetasit A.C, si dhe të shtetasit U.C, dhe për pasojë dhe mundësia financiare e subjektit për blerjen e apartamentit në Tiranë, me burime të ligjshme.

2.10 Konstatimet e Komisionit

Në lidhje me blerjen e pasurinë apartament në Tiranë, rezultoi se:

- a. nuk është siguruar asnjë provë bindëse që tregon mundësinë financiare të huadhënësit;
- b. nuk rezulton asnjë provë direkte apo indirekte për marrjen/dhënien e shumës së huas;
- c. ka mungesë dokumentacioni provues mbi mundësi financiare për blerjen e apartamentit në Tiranë, në shumën 8.500.000 lekë; si dhe
- d. subjekti nuk provon mundësitë financiare për shlyerjen e huas.

Në lidhje me këto konstatime për pasurinë apartament në Tiranë, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe pikën 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

2.11 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Në lidhje me pasurisë apartament 2+1, me sip. 111 m² dhe garazh me sip. 30 m², ndodhur në Sauk, Tiranë, subjekti ka mbajtur të njëjtin qëndrim, si edhe gjatë hetimit administrativ, duke argumentuar se referuar akteve të depozituar në cilësinë e provës, konfirmohet se shuma 80.000 euro është marrë faktikisht *cash* nga shtetasi U.C, por është marrë për llogari të shtetasit A. C dhe i është kthyer *cash* prej bashkëshortit të subjektit, po shtetasit U.C.

Shtetasi A.C ka qenë një lloj ndërmjetësi apo garanti për marrjen e huas. Subjekti ka shpjeguar se midis shtetasve A dhe U.C ka pasur edhe më herët një marrëdhënie huaje, të cilën palët kanë zgjedhur të mos e formalizojnë për shkak të marrëdhënieve të mirëbesimit midis tyre, e motivuar nga lidhja e afërt familjare. Fakti i ekzistencës së kësaj marrëdhënie ka gjetur pasqyrim, si në kontratën e huas së lidhur midis shtetasit A.C dhe bashkëshortit të subjektit, ashtu edhe në deklaratat noteriale të lëshuara nga shtetasi U.C, në të cilat konfirmohet kthimi i huas për llogari të shtetasit A.C. Për më tepër, këto fakte janë deklaruar edhe prej saj si në deklaratën periodike vjetore ashtu edhe në deklaratën *Vetting*. Por, pavarësisht kësaj marrëdhënieje, burimi i drejtpërdrejtë i shumës së marrë prej shtetasit A.C në formën e huasë është shtetasi U.C. Shkaku për të cilin shtetasi A.C ka marrë shumën që më pas ia ka kaluar subjektit dhe bashkëshortit, tek shtetasi U. C, ka qenë marrëdhënia e hershme e huas midis tyre.

Konkretisht në kontratën e huas së lidhur midis bashkëshortit të subjektit dhe shtetasit A.C është evidentuar në mënyrë të shprehur deklarimi i huadhënësit se: *“Këtë shumë ai ua kishte dhënë në huapërdorje njerëzve të afërt të familjes së tij përpara disa vjetësh dhe kjo shumë i është kthyer në këtë periudhë.”* Për më tepër, subjekti ka shpjeguar se edhe shtetasi U.C konfirmon në gjithë deklaratimet e tij faktin se shuma në fjalë i është dhënë prej tij në këtë periudhë. Ky fakt është deklaruar në vijimësi nga palët në këtë marrëdhënie që nga momenti i hartimit të kontratës së huas.

Këtë shumë shtetasi U.C, si ortak me 80% të kapitalit të shoqërisë, e ka tërhequr nga arka e shoqërisë, e cila ka pasur mjaftueshëm gjendje të disponueshme për të dhënë këtë shumë. Marrja dhe kthimi i huas është bërë brenda të njëjtit vit kalendarik, është marrë në janar dhe është kthyer në dhjetor, për pasojë, nuk gjendet e pasqyruar në bilancin e shoqërisë, i cili është një akt që referuar standardeve të kontabilitetit plotësohet gjatë tremujorit të parë të vitit pasardhës. Dhënia e kësaj shume edhe në eventualitetin që do të shlyhej prej subjektit brenda afatit të parashikuar në kontratën e huas (afat 10-vjeçar), referuar kapacitetit të burimeve financiare të shoqërisë, nuk do të cenonte zhvillimin normal të aktivitetit të shoqërisë.

Mospasqyrimi në bilanc i shumës së tërhequr nga arka e shoqërisë është bërë në kushtet e plotësisimit të pasqyrave financiare pas shlyerjes së huas nga subjekti. Nëse kjo shumë nuk do të mundësohej të kthehej brenda vitit financiar, sigurisht që në pasqyrat financiare të shoqërisë për vitin 2012 do të gjente pasqyrim pakësimi i mjeteve monetare në arkën e shoqërisë.

Subjekti ka pretendua se huaja e dhënë nga shtetasi U.C ka burim të ardhurat e gjeneruara nga aktiviteti privat i tij, për të cilën janë paguar tatimet përkatëse sipas legjislacionit në fuqi. Veprimet që ka bërë shtetasi U.C me arkën e shoqërisë, janë veprime të cilat nuk kanë pse të ndikojnë në procesin e saj të rivlerësimit, si dhe nuk i bëjnë këto të ardhura të paligjshme.

Në lidhje me burimet e ligjshme të shtetasit A.C, subjekti ka pretenduar se është në pamundësi objektive dhe nuk disponon dokumentacion për të ardhurat e gjeneruara prej tij para vitit 1998,

për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar dhe mosruajtjes së akteve edhe për shkak se ky shtetas jeton në SHBA, që prej vitin 1998.

Në lidhje me shlyerjen e kësaj shume, sikurse është deklaruar edhe gjatë hetimit, subjekti ka shpjeguar se kjo shumë është shlyer nga shitja e apartamentit në Fier, në shumën 68.000 euro, shtetasve I e D.B.

Subjekti ka pretenduar se konstatimet e Komisionit se nuk ka asnjë dokument që të provojë dhënien/marrjen e huas, apo pagesat e kryer tek shitësi, mandatpagesat, apo dokument/transfert bankare, nuk qëndrojnë, për sa në kontratën e huadhënies të lidhur midis palëve në datën 17.1.2012, gjen pasqyrim në mënyrë të shprehur fakti se kjo shumë është marrë, po më 17.1.2012. Për më tepër, një fakt i tillë është deklaruar prej subjektit në DPV-në e vitit 2012 edhe në deklaratën *Vetting*. Ashtu sikurse arsyeton edhe Kolegji i Posaçëm i Apelit në praktikën e tij, në referim të parashikimeve të nenit 690 të Kodit Civil dhe nenit 253 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe parashikimeve të pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, kontrata e huadhënies përbën provë të plotë të deklarimeve që janë bërë përpara noterit për faktet që kanë ngjarë në prani të tij ose për veprimet e kryera prej tij dhe deklaratat e interesave privatë e pasurorë janë, gjithashtu, prova që konfirmojnë përmbajtjen e kontratës së huas.

2.12 Vlerësimi i Komisionit

Komisioni vlerëson se subjekti, pas kalimit të barrës së provës, nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit administrativ.

Subjekti nuk arriti të provojë burimet e ligjshme të huadhënësit real z. A. C, për të cilin nuk disponohet dokumentacion provues mbi të ardhurat e tij përpara vitit 1998.

Gjithashtu, subjekti nuk provoi që shtetasi U.C, i ka dhënë shumën 80.000 euro, pasi ky veprim nuk dokumentohet, si dhe nuk gjendet i reflektuar në asnjë akt të shoqërisë. Sikurse është argumentuar më sipër, ky shtetas, nuk ka pasur tagra të veprojë me arkën e shoqërisë, si të ishin të ardhurat e tij personale. Shoqëria një vit përpara dhënies së huas nuk kishte shpërndarë dividend, i cili mund të ishte në funksion të ortakëve. Në këtë arsyetim, nuk provohet që huadhënësi U.C si individ, të ketë disponuar këto shuma.

Pretendimet e subjektit se z. U. C ka tërhequr nga arka e shoqërisë shumën 80.000 euro dhe ia ka dhënë subjektit, nuk duket bindës dhe i provuar prej tij.

Ky veprim mbeti i paprovuar si i kryer, pasi nuk ka asnjë gjurmë të tij në librat e shoqërisë.

Referuar pikës 1, të nenit 14²⁶, të ligjit nr. 9901/2008, “Për tregtarët e shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, parashikohet se: “*Gjatë ushtrimit të të drejtave, ortakët dhe aksionarët veprojnë, duke marrë parasysh interesat e shoqërisë dhe të ortakëve apo të aksionarëve të tjerë. I njëjti detyrim zbatohet edhe për administratorët, anëtarët e këshillit të administrimit apo të këshillit mbikëqyrës*”.

Nga këto dispozita, rezulton se ortakët dhe administratorët në shoqëritë tregtare, sikurse ishte z. U. C, duhet të veprojnë në interesin më të lartë të shoqërisë. Shpjegimi i dhënë se z. U. C se ka marrë shumën 80.000 euro dhe nuk e ka pasqyruar në librat e shoqërisë, pasi është dhënë

²⁶ Neni 14 “Parimi i detyrimit për besnikëri”.

dhe është kthyer brenda vitit 2012, nuk qëndron, pasi ai nuk mund të parashikonte se kur do t'i kthehej shuma 80.000 euro nga z. M. S. Sipas parashikimit të kontratës së huas, z. M.S duhet t'i kthente këto shuma, brenda një afati 10-vjeçar. Për pasojë, z. U.C, nuk kishte se si të mos e evidentonte në librat e shoqërisë, këtë shumë të tërhequr prej tij, në favor të një pale tjetër.

Referuar argumentit të pretenduar nga subjekti se në referim të parashikimeve të nenit 690 të Kodit Civil dhe të nenit 253 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe parashikimeve të pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, kontrata e huadhënies përbën provë të plotë të deklarimeve që janë bërë përpara noterit për faktet që kanë ngjarë në prani të tij, Komisioni arsyeton se aktet ligjore janë hartuar në përmbushje të deklarimeve të subjektit para noterit dhe se nuk janë ngritur dyshime për anën formale të akteve të hartuara nga subjekti para noterit. Por, Komisioni ka konstatuar se këto akte kanë karakter deklarativ, të pambështetura në dokumentacion provues dhe të pa gjurmueshme.

Duke qenë se nga hetimi i kryer, as huadhënësi A.C dhe as U.C si individ, nuk provuan burimet e ligjshme, për dhënien e kësaj shume, rezultoi në pamundësi financiare, si dhe asnjë nga këto veprime nuk u gjurmua me dokumentacion/historik bankar, apo prova të tjera të disponimit të të ardhurave për të cilat të ishin paguar tatimet, Komisioni arsyetoi se huadhënësi s'ka burime të ligjshme për dhënien e huas, s'ka prova që kjo hua të jetë dhënë nga huadhënësi A.C, apo ndërmjetësi U.C.

Nisur nga fakti se subjekti nuk ka deklaruar kursime *cash* në DPV në vite, si dhe për faktin se si burim për blerjen e kësaj pasurie ka deklaruar të ardhurat nga shitja e apartamentit në Fier, për këto arsye, në analizën financiare të kryer nga Komisioni, nuk u analizuan të ardhurat e ligjshme të krijuara nga pagat e saj dhe të bashkëshortit.

Për sa më sipër, nuk u provuan bindshëm të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen e pasurisë, në përputhje me pikën 3, të neni D, të Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, në kuptim të kësaj dispozite kushtetuese dhe neneve 30 dhe 33, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit rezulton të jetë në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e apartamentit në Tiranë.

3. Pasuria garazh me sip. 30 m², në Sauk, Tiranë

Vlera e deklaruar: 7.000 euro.

Pjesa në përqindje: pasuri e pandarë.

Burimi i krijimit: nga shitja e pasurisë apartament 2+1, në Fier, në shumën 55.000 euro banesa + 18.000 euro mobilimi.

Deklarimi në DPV: e vitit 2012, ka deklaruar burimin e krijimit për këtë pasuri nga shitja e apartamentit+ mobiliet, në Fier.

Mënyra e fitimit: blerë me kontratën nr. ***, datë 5.6.2012.

3.1 Hetimi i kryer nga Komisioni

ASHK-ja Drejtoria Vendore²⁷ Tirana Rurale 1 ka konfirmuar se shtetasi M. Sh. S, ka të regjistruar pasurinë nr. ***, vol. **, f. ***, z. k. ***, lloji i pasurisë “garazh”, me sip. 30 m² (pasuri aktive).

²⁷Me shkresën nr. *** prot., datë 21.10.2019.

Në referencë të konstatimeve të Komisionit, në lidhje me pasuritë trajtuar në pikat 1 dhe 2 të këtij raporti, për ligjshmërinë e burimeve të krijimit të këtyre pasurive, subjekti rezulton në mungesë të dokumentacionit justifikues për blerjen e pasurisë garazh me sip. 30 m², në shumën 7.000 euro, në Tiranë.

Në lidhje me këto konstatime të Komisionit, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në pikën 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

Subjekti ka dhënë të njëjtat shpjegime, si për pasurinë apartament edhe për pasurinë garazh, duke argumentuar se për blerjen e garazhit fillimisht është përdorur huaja e marrë nga z. A. C dhe, më pas, huaja u shlye me të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit në Fier.

3.2 Vlerësimi i komisionit

Referuar qëndrimit të Komisionit, për pasurinë apartament, trajtuar në pikën 2 dhe për pasurinë garazh është arritur në përfundimin se nuk u provuan bindshëm të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen e garazhit, në përputhje me pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, në kuptim të kësaj dispozite kushtetuese dhe neneve 30 dhe 33, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit rezulton të jetë në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie në Tiranë.

4. Automjeti i markës “Daimler Chrysler”, tipi *-C ** CDI, me targa AA***AF, vit prodhimi 2000**

Deklarimi në DPV²⁸: subjekti ka deklaruar se kjo është pasuri e dhuruar nga vëllai i bashkëshortit.

4.1 Hetimi i kryer nga Komisioni

DPSHTRr-ja²⁹ konfirmon se shtetasi M. S, ka në pronësi automjetin me targa AA *** AF, përfituar nëpërmjet kontratës së dhurimit nr. ***, datë 7.4.2010, me palë dhuruese I.S dhe palë përfituese M.S, për automjetin e lloji autoveturë e markës “Daimler Chrysler”, tipi **-C ** CDI.

Nga verifikimi në sistemin *TIMS*, ka rezultuar se shtetasi I. Sh. S ka qenë në Shqipëri në periudhën e blerjes, zhdoganimit dhe dhurimit të këtij automjeti, vëllait M.S.

Komisioni i kërkoj subjektit informacion mbi burimet e ligjshme që kanë shërbyer për blerjen e këtij automjeti.

Në përgjigje të pyetësorit³⁰, subjekti ka shpjeguar se: *“I.S, është vëllai i bashkëshortit, i cili ka dhuruar automjetin tip ‘Daimler Chrysler’ bashkëshortit të subjektit, fakt i cili është pasqyruar edhe në kontratën e dhurimit të automjetit nr. ***, datë 7.4.2010. Në dijeninë e subjektit, pagesa prej 2.900 eurosh për blerjen e mjetit është kryer nga dhuruesi I. S në cash. Edhe vlera e zhdoganimit prej 307.841 lekësh është paguar nga shtetasi I. S në degën e doganës Durrës, fakt i cili pasqyrohet edhe në deklaratën doganore të përpiluar me rastin e zhdoganimit të automjetit në degën e doganës Durrës”.*

²⁸ E vitit 2010.

²⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 11.10.2019.

³⁰ Ardhur me e-mail-in e datës 9.4.2021.

Lidhur me burimet për blerjen e automjetit prej shtetasit I.S, subjekti ka shpjeguar se: “*Shtetasi I. S i fundit prej vitit 1997 ka jetuar dhe punuar në Boston, SHBA, prej nga është kthyer në datën 31.12.2009. Pasi ka qëndruar në Shqipëri deri në shtator të vitit 2015 është larguar sërish për në SHBA, ku edhe jeton aktualisht. Të ardhurat e përdorura për blerjen e mjetit të dhuruar përfaqësojnë të ardhura të realizuara nga puna e tij në SHBA*”.

Për të provuar të ardhurat e realizuara, subjekti ka paraqitur aktin “Social Security Statement” të lëshuar në rrugë elektronike nga “Social Security Administration”, që i është dërguar nëpërmjet postës elektronike prej shtetasit I.S. Nga të dhënat e evidentuara në këtë akt (në faqen 3) rezulton se të ardhurat e realizuara nga shtetasi I.S për vitet 1997 – 2009, janë në shumën totale 255.860 USD, të konkretizuara ndër vite.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë³¹ dhe **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier**³², kanë konfirmuar se subjekti i rivlerësimit Lindita Sinanaj, gjatë ushtrimit të detyrës në këto institucione nuk ka zhvilluar procese gjyqësore me shtetasin I.Sh.S si palë ndërgjyqëse, as si gjyqtare e vetme dhe as si anëtare e ndonjë trupe gjyqësore.

Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti, mbi të ardhurat e realizuara nga shtetasi I. S, mbi burimet e ligjshme të vitet 1997 – 2009, konfirmohet se të ardhurat e siguruar nga dhuruesi i automjetit kanë qenë të mjaftueshme për të mbuluar blerjen dhe pagesën e detyrimit doganor për automjetin në vitin 2010.

✓ Për sa më sipër, konfirmohen deklaratimet e subjektit me dokumentacionin e administruar.

5. Automjet tip “Volkswagen Golf”, me targa AA * LX, vit prodhimi 2014, blerë në shumën 5.000 euro**

Burimi i krijimit: blerë me shumën e mbetur pa shlyer nga shitja e banesës 2 + 1, në Fier, kur është paguar kësti i fundit nga blerësi i banesës në vitin 2016.

Deklarimi në DPV³³: ka bërë të njëjtin deklaram si në deklaratën *Vetting*.

Mënyra e fitimit: me kontratën nr. ***, datë 24.1.2017.

5.1 Hetimi i kryer nga Komisioni

DPSHTRr-ja³⁴ ka konfirmuar se në pronësi të subjektit të rivlerësimit Lindita Sinanaj, rezulton automjeti me targa AA *** LX. regjistruar në DRSHTRr-në Tiranë. Bashkëlidhur rezulton kontrata e shitblerjes nr. ***, datë 24.1.2017, e automjetit nënshkruar ndërmjet subjektit dhe zj. Sh.C. Për herë të parë regjistrimi i këtij automjeti është në emër të znj. Sh. C në datën 22.5.2015, e cila e ka blerë në shumën 23.000 euro.

Nga aktet e dosjes depozituar nga DPSHTRr-ja ka rezultuar se shtetasja Sh.C, me kontratën e shitblerjes, datë 22.5.2015, e ka blerë këtë automjet të ri në vitin 2015, nga “P. A” sh.p.k., në shumën 23.000 euro.

Nga verifikimi i të dhënave të marra nga sistemi *TIMS*, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë kaluar kufirin me këtë automjet.

³¹Me shkresën nr. *** prot., datë 9.4.2021.

³²Me shkresën nr. *** prot., datë 7.4.2021.

³³E vitit 2017.

³⁴Me shkresën nr. *** prot., datë 11.10.2019.

AMF-ja, nëpërmjet informacionit të aksesuar *online* të qendrës së sigurimit të detyrueshëm motorik, ka informacion se për automjetin me targa AA *** LX, znj. Lindita Sinanaj ka blerë për herë të parë policë sigurimi për vitet 2017-2018, pasi e ka blerë këtë automjet.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit³⁵ ka depozituar informacion në lidhje me masa administrative gjoba të vendosura ndaj këtij automjeti, ku ka rezultuar se ka 2 gjoba të vendosura ndaj automjetit me targa AA *** LX, në emër të shtetasës Lindita Sinanaj në datat 26. 8.2020 dhe 9.11.2020.

Nga shqyrtimi i akteve ka rezultuar se çmimi i blerjes së automjetit nga subjekti i rivlerësimit në datën 24.1.2017, në shumën 5.000 euro është shumë më i ulët, krahasuar me çmimin e blerjes nga shitësja, e cila e kish blerë të ri këtë automjet në datën 22.5.2015, në shumën 23.000 euro.

5.2 Në lidhje me çmimin e blerjes, subjekti³⁶ ka shpjeguar se *shtetasja Sh.C është bashkëshortja e shtetasit U. C, i cili është djali i dajës së saj, për lidhjen me të cilin ajo ka deklaruar edhe më parë pranë Komisionit. Automjeti tip “Volkswagen Golf” është blerë në janar të vitit 2017 nga shtetasja Sh. C, e cila në muajin dhjetor të vitit 2016, duke udhëtuar me automjetin në fjalë ka pësuar aksident. Pas këtij aksidenti, automjeti i është shitur subjektit nga shtetasja Sh.C, pasi ajo nuk e përdorte më për shkak të tronditjes psikologjike të shkaktuar nga aksidenti. Duke pasur parasysh këtë fakt, por edhe lidhjen e afërt familjare, si dhe faktin se automjeti megjithëse u riparua, nuk u kthye më në gjendjen teknike të mëparshme, palët ranë dakord që automjeti të blihej prej subjektit në shumën 5.000 euro. Për të provuar këtë fakt, subjekti ka paraqitur një deklaratë noteriale të lëshuar nga shtetasja Sh. C që konfirmojnë faktet që kanë ndikuar në formimin e vullnetit të palëve lidhur me çmimin e blerjes së mjetit në fjalë.*

5.2 Komisioni ka hetuar në lidhje me ndonjë konflikt të mundshëm interesi të subjektit me shitësen e automjetit.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë³⁷ dhe **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier**³⁸, kanë konfirmuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka zhvilluar procese gjyqësore me palë ndërgjyqëse shtetasen Sh.C, gjatë kohës së ushtrimit të detyrës së saj si gjyqtare.

5.3 Nga verifikimi i akteve të depozituara nga subjekti nuk rezulton asnjë dokument, si dhe nuk ka provuar se automjeti të ketë pësuar aksident, i cili të ketë ulur vlerën e automjetit, si p.sh. aktkonstatim të mbajtur nga policia për aksidentin e kryer, ndonjë akt të lëshuar nga shoqëria e sigurimit për dëmshpërblim apo çdo dokument tjetër që mund të shërbente si provë direkte apo indirekte, për rrjedhojë, duket se çmimi i blerjes së këtij automjeti duket si çmim fiktiv.

5.4 Analiza financiare

Duke qenë se si burim për blerjen e automjetit, subjekti ka deklaruar se është përdorur shuma 5.000 euro, e kështu të fundit të paguar nga blerësi i apartamentit në Fier, në vitin 2016, z. I.B Komisioni konstatoi se:

³⁵Me shkresën *** prot., datë 6.4.2021.

³⁶Në përgjigjet e pyetësorit ardhur me e-mail-in e datës 9.4.2021.

³⁷Me shkresën nr. ** prot., datë 9.4.2021.

³⁸Me shkresën nr. *** prot., datë 7.4.2021.

- a. nuk u provuan burimet e ligjshme që kanë shërbyer për blerjen e pasurisë, si dhe nuk u dokumentua pagesa e kryer;
- b. subjekti nuk provoi me dokumentacion dëmtimin apo zhvlerësimin e automjetit për shkak të aksidentit të pësuar;
- c. çmimi i blerjes së automjetit nga subjekti është shumë më i ulët nga vlera reale e automjetit.

Në lidhje me këto konstatime, subjektit iu kalua barra e provës bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në pikën 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

5.5 Qëndrimi i subjektit

Subjekti i rivlerësimit në lidhje me konstatimet e Komisionit, ka shpjeguar se çmimi i shitjes së automjetit, është për shkak të dëmtimit që ka pësuar automjeti nga aksidenti në dhjetor të vitit 2016. Shitësja për shkaqe psikologjike nga tronditja që pësoi për shkak të aksidentit nuk donte që të vijonte ta mbante këtë automjet. Gjithashtu, edhe për shkak të marrëdhënies familjare që kanë, shitësja e automjetit është nusja e djalit të dajës (U. C), ia ka shitur këtë automjet subjektit në çmimin 5.000 euro.

Subjekti ka argumentuar se për blerjen e automjetit janë përdorur të ardhurat/kësti i fundit i paguar nga blerësi i apartamentit në Fier, shtetasi I. B.

Subjekti në mbështetje të pretendimeve të saj ka depozituar një raport vlerësimi të një inxhinieri të licencuar, i cili ka arritur në konkluzionin se automjeti i është nënshtruar një aksidenti, i cili ka ulur vlerën e tij, në çmimin që e ka blerë subjekti.

5.6 Vlerësimi i Komisionit

Komisioni konstaton se subjekti edhe pas kalimit të barrës së provës nuk arriti të provonte pretendimet e saj, pasi nuk depozitoi prova bindëse të aksidentit të automjetit nga shitësja në vitin 2016, që të provohej ulja e vlerës së automjetit në mënyrë të ndjeshme.

Raporti i vlerësimit të automjetit të bërë nga një ekspert privat, mbi bazën e fotove të aksidentit të vitit 2016, por edhe verifikimit teknik të bërë nga eksperti privat në vitin 2021, nuk mund të merret për bazë si provë, pasi nuk konfirmohet nga asnjë institucion zyrtar se ulja e vlerës së automjetit dhe dëmet reale të shkaktuara kanë ndodhur nga një aksident në vitin 2016, sikurse pretendon subjekti.

Raporti i vlerësimit të automjetit depozituar nga subjekti është hartuar pas kalimit të barrës së provës dhe gjatë hetimit administrativ nga Komisioni nuk është administruar asnjë provë, aktkonstatimi i policisë, foto, fatura, apo dokument nga SGS, i cili bën kontrollin teknik të automjetit, të cilat subjekti mund t'i kishte depozituar.

Raporti i vlerësimit kryer në vitin 2021, ka paraqitur gjendjen teknike të automjetit në momentin e kontrollit, por nuk provon aksidentin e pësuar nga automjeti në vitin 2016, i cili

ka ndikuar në uljen e vlerën së automjetit. Për rrjedhojë, për Komisionin kjo provë nuk është bindëse për të konfirmuar pretendimet e subjektit.

Referuar deklaratimeve të subjektit që si burim për blerjen e automjetit janë përdorur 5.000 euro nga pagesa e shumës së mbetur nga shitja e apartamentit në Fier, Komisioni arsyeton se subjekti nuk arriti të provonte burimin e ligjshëm, që ka shërbyer për blerjen e automjetit, sikurse është argumentuar në pasurinë nr. 1.

Duke qenë se subjekti nuk arriti të provojë pretendimet e saj, në lidhje me aksidentin e pësuar në automjet, rezultoi se çmimi i blerjes së automjetit nuk paraqet vlerën reale të tij.

Në përfundim të analizimit të shpjegimeve dhe akteve të depozituar nga subjekti, Komisioni ka arritur në përfundimin se nuk u provuan bindshëm të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen e automjetit, në përputhje me pikën 3, të neni D, të Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, në kuptim të kësaj dispozite kushtetuese dhe neneve 30 dhe 33, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit rezulton të jetë në mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e këtij automjeti.

6. Gjendje në llogarinë bankare, në “Raiffeisen Bank”, në emër të bashkëshortit, në datën 23.1.2017. Vlera 1.072.552.13 lekë.

Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës vërtetimin, datë 23.1.2017, nga “Raiffeisen Bank”, me të cilën vërtetohet se shtetasi M. S ka të çelur llogarinë nr. ***, në monedhë në lekë, me gjendje në datën 23.1.2017, në vlerën 1.072.552.13 lekë.

“**Raiffeisen Bank**”³⁹ konfirmon llogari rrjedhëse në emër të shtetasit M. S me gjendje në datën 27.1.2017, në vlerën 1.072.552.13 lekë.

✓ **Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjen nga “Raiffeisen Bank”.**

7. Gjendje në llogarinë në “Raiffeisen Bank”, në emër të subjektit në shumën 4.088,88 lekë dhe në emër të bashkëshortit, në shumën 29.12 lekë

“**Raiffeisen Bank**”⁴⁰ ka konfirmuar llogari kursimi në emër të bashkëshortit të subjektit dhe gjendjen e llogarisë në emër të subjektit.

8. Llogari bankare në “Credins Bank”, me gjendje në shumën 375.313 lekë, në emër të bashkëshortit të subjektit

Subjekti nuk ka deklaruar burim krijimi të kësaj shume, por nga analizimi i dokumentacionit bankar si burim kanë shërbyer të ardhurat nga paga.

“**Credins Bank**”⁴¹ ka konfirmuar se shtetasi M. S është klient i kësaj banke me llogari page me gjendje në datën 27.1.2017, në vlerën 374.613 lekë.

✓ **Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjen e ardhur nga “Credins Bank”.**

³⁹Me shkresën nr. *** prot., datë 4.10.2019.

⁴⁰Me shkresën nr. *** prot., datë 4.10.2019.

⁴¹Me shkresën nr. *** prot., datë 19.7.2017, drejtuar ILDKPKI-së.

9. Depozitë bankare në “Intesa Sanpaolo Bank”, në shumën 1.151.485 lekë, në emër të bashkëshortit, në datën 23.1.2017

Subjekti nuk ka deklaruar burim krijimi.

“Intesa Sanpaolo Bank”⁴² ka konfirmuar se shtetasi M. S ka disponuar depozitë në lekë me gjendja në datën 27.1.2017, në shumën 1.151.485 lekë.

10. Analiza financiare për periudhën 2003 – 2016.

Të ardhurat e ligjshme sipas vërtetimit për të ardhurat *neto* lëshuar nga institucionet përkatëse për subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshortit, të cilat janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore në zbatim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

- Të ardhurat nga shitja e automjeteve janë bazuar në deklaratimet e subjektit dhe dokumentacionin e administruar në dosje.
- Të ardhurat nga dhurimet janë përlogaritur në bazë të deklaratimit të subjektit në DPV-në e vitit 2014⁴³.

Shpenzimet që u morën në konsideratë si vijon:

- shpenzimet e jetesës, për periudhën 2003 – 2016, janë bazuar në shpenzimet e përcaktuara në raportin e ILDKPKI-së⁴⁴;
- shpenzimet e jetesës, për periudhën 1994 – 2000, janë përlogaritur në masën 66% referuar vendimit nr. 18/2019 (JR) të Kolegjit;
- shpenzimet për udhëtime jashtë shtetit, u analizuan bazuar në të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, konkretisht lëvizjet hyrje-dalje nëpërmjet sistemit *TIMS* të subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve, si dhe u krahasuan me deklaratimet e subjektit. Për përlogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit janë marrë si referencë, vendimi nr. 11/2019 (JR) datë 22. 5.2019, i Kolegjit, si dhe deklaratimet e subjektit, ndërsa për shpenzimet e qëndrimit janë llogaritur 50 euro/ditë shpenzim qëndrimi dhe ushqimi.
- shpenzimet për blerje automjeti u bazuan në deklaratimet vjetore të subjektit, si dhe në dokumentacionin⁴⁵ përkatës;
- shpenzimet e shkollimit të fëmijëve janë bazuar në deklaratimin e subjektit dhe dokumentacionin e administruar në dosje (vërtetime nga institucionet arsimore dhe statement bankare); si dhe
- shpenzimet për kurim janë përfshirë në analizën financiare bazuar në deklaratimin dhe dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti.

Për analizimin e kursimeve u morën në konsideratë:

- deklaratimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat e interesave pasurore private/vjetore dhe përgjigjeve në pyetësor.

Në analizë janë marrë në konsideratë gjendja e likuiditeteve në bankë, në fillim dhe në fund të vitit të analizuar, bazuar në të dhënat e pasqyrave të lëvizjeve bankare.

⁴²Me shkresën nr. *** prot., datë 7.7.2017, drejtuar ILDKPKI-së.

⁴³Dhurimet nga familjarët për djalën për studimet jashtë vendit.

⁴⁴Shkresë nr.*** prot., datë 4.3.2019, nga ILDKPKI-ja.

⁴⁵Informacioni i dorëzuar nga DPSHTRr-ja.

Aneks 2

Analiza financiare për periudhën 2003 – 2016

Pershkrimi	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
PASURI	200 000	51 651	-46 245	130 864	728 918	348 161	296 303	-768 315	1 282 566	9 511 017	352 068	236 503	402 572	146 937
Automjet benz	200 000													
Automjet Golf					500 000									
Apartament ne Sauk, Tirane 111 m2										8 500 000				
Garazh ne Sauk										978 040				
DIFERENCËLIKUIDITETI	-	51 651	-46 245	130 864	228 918	348 161	296 303	-768 315	1 282 566	32 977	352 068	236 503	402 572	146 937
LIKUIDITETE (FUND VIII)	700 000	751 651	705 406	836 270	1 065 188	1 413 349	1 709 652	941 338	2 223 904	2 256 881	2 608 950	2 845 453	3 248 024	3 394 961
Gjendje cash	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	300 000	300 000	300 000	300 000
Likuiditete ne banke	700 000	751 651	705 406	836 270	1 065 188	1 413 349	1 709 652	941 338	2 223 904	2 256 881	2 308 950	2 545 453	2 948 024	3 094 961
DETYRIME	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
PASURINETO	200 000	51 651	-46 245	130 864	728 918	348 161	296 303	-768 315	1 282 566	9 511 017	352 068	236 503	402 572	146 937
TEARDHURA	997 341	1 232 029	1 351 653	1 697 581	2 044 783	1 978 953	2 048 602	1 931 148	1 995 553	2 337 559	2 388 986	2 762 561	3 033 696	2 175 818
Te ardhura te subjektit	620 022	817 169	823 947	856 872	864 361	917 324	1 095 883	1 072 864	1 154 985	1 240 462	1 298 471	1 364 222	1 357 514	1 395 509
Te ardhura te bashkeshortit	377 319	414 860	527 706	840 709	930 422	1 061 629	952 719	858 284	840 568	1 097 097	1 090 515	1 056 648	1 276 182	780 309
Te ardhura nga shitja e njetit benz					250 000									
Te ardhura nga dhurimet e deklaruar ne DPV 2014												341 691		
Te ardhura nga shitja e makines Volkswagen													400 000	
SHPENZIME	375 456	578 240	505 625	668 316	974 100	762 494	608 207	936 100	1 135 336	1 619 640	1 050 918	2 062 164	3 539 352	2 668 592
Shpenzime jetese	375 456	375 456	438 228	438 228	943 872	546 480	546 480	546 480	546 480	564 096	564 096	828 201	672 828	705 276
Shpenzime udhetimi		202 784	67 397	230 088	30 228	16 014	61 727	277 620	320 856	27 944	0	168 833	392 991	315 179
Shpenzime mobilimi										900 000				
Shpenzime jetese E. S France												336 264	991 080	973 944
Shpenzime shkollimi E. S								60 000	147 000	57 600		56 338	55 624	54 663
Shpenzime qiraje E. S France												224 176	636 349	409 861
Shpenzime shkollimi D. S								52 000	121 000	70 000	448 672	448 352	440 480	209 669
Shpenzime per nderhyrje kirurgjike ne Royal Diagnostic Center														350 000
Ndertimi i shteses sipas pyetesorit						200 000								
Shpenzime per rivleresimin e apartamentit ne Fier											38 150			
REZULTATI FINANCIAR	421 885	602 138	892 273	898 401	341 766	868 298	1 144 092	1 763 363	-422 349	-8 793 098	986 000	463 894	-908 228	-639 710

- Referuar analizës financiare të kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor, për periudhën 2003 – 2016, subjekti ka rezultuar me balancë totale negative për krijimin e likuiditeteve dhe për të përbulluar shpenzimet familjare në shumën **10.763.385 lekë**.

10.1 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Në lidhje me analizën financiare të kryer nga Komisioni, për periudhën 2003 – 2016, subjekti ka pretenduar se nuk janë pasqyruar shumat *cash* sipas deklarimeve, ndër vite, të subjektit dhe ka shpjeguar se referuar deklarimeve sipas DPV-ve, shumat respektive do të ishin si në tabelën vijuese:

Viti	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Gjendje <i>cash</i> në lekë	166.830	0	300.000	300.000	0	676.350

Subjekti ka pretenduar se nuk janë llogaritur saktë gjendjet e llogarive bankare në fund të vitit për periudhën 2008 – 2016, si dhe të interesave të ardhura nga depozita në lekë.

Subjekti ka pretenduar se Komisioni i ka llogaritur tejet të larta shpenzimet e jetesës, shkollimit, dhe qirasë të djalit të tyre E. S, në Francë. Subjekti ka pretenduar se djali ka shpenzuar 600 euro/muaj për jetesë dhe shpenzime qiraje, ndërkohë që qiraja ka rezultuar 400 euro/muaj. Për qiranë subjekti ka depozituar një dokument ku vërtetohet se për periudhën nëntor 2015 – dhjetor 2016 nga shpenzimi i qirasë i rimbursohet një shumë mujore prej 177.05 euro/muaj. Komisioni i ka llogaritur shpenzime për jetesë pa përfshirë qiranë në shumën 600 euro/muaj.

10.2 Vlerësimi i Komisionit

Në lidhje me analizën financiare, Komisioni ka konstatuar se pas shqyrtimit të pretendimeve të subjektit, si dhe verifikimit të deklarimeve të gjendjes së likuiditeteve *cash*, në DPV, ky pretendim i subjektit do të merret në konsideratë pjesërisht vetëm për vitet 2011 – 2012, duke u reflektuar edhe ndryshimi përkatës në vitet vijuese si në tabelën në vijim.

VITI	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Gjendje <i>cash</i> lekë	166.830	166.830	466.830	466.830	466.830	466.830
Deklarimi në DPV tek formulari i ndryshimeve në pasurinë e subjektit	200.000 kursime nga të cilat 33.170 lekë janë në llogari bankare	Nuk deklaron shtesë as pakësim (gjendja do të mbartet)	300.000 lekë shuma në të holla kursime nga të ardhurat familjare	Nuk deklaron shtesë as pakësim (gjendja do të mbartet)	Nuk deklaron shtesë as pakësim (gjendja do të mbartet)	Nuk deklaron shtesë as pakësim (gjendja do të mbartet)

Në lidhje me pretendimin e subjektit se nga Komisioni nuk janë llogaritur saktë gjendjet e llogarive bankare në fund të vitit për periudhën 2008 – 2016, si dhe të interesave të ardhura nga depozita në lekë, Komisioni ka konstatuar se ky pretendim qëndron dhe janë verifikuar pasaktësitë në llogaritje dhe këto pretendime janë pasqyruar në tabelën e analizës financiare.

Gjithashtu, subjekti ka pretenduar shpenzime jetese më të ultë për vitet 2015 – 2016, pasi ka rezultuar me balance negative, ndërkohë e ka pranuar llogaritjen e Komisionit për vitin 2014, me të njëjtin standard, por aty nuk ka pasur balancë negative.

Ky pretendim i subjektit qëndron vetëm pjesërisht për vitin 2015, pasi për qiranë e llogaritur për 12 muaj, nga dokumentacioni i paraqitur, evidentohet se djalit të subjektit i është rimbursuar nga shteti francez një shumë prej 354.1 euro, e cila u reflektua në analizën financiare.

Shpenzime me kartë/muaj sipas statementit të llogarisë në Francë	n/a	n/a	578 euro/m
Shpenzime jetese (600/euro/muaj)	336 264	991 080	973 944
Shpenzime shkollimi (tarifa 402 euro/vit)	56 338	55 624	54 663
Shpenzime qiraje (400 euro/muaj) nga nëntor 2015 - dhjetor 2016, i rimbursohet 177,05 euro/muaj për qiranë	224 176	611 978	409 861
Shpenzime jetese + qiraje sipas Komisionit		970	852
Shpenzime jetese + qira (euro /muaj sipas eurostat)		1.041	938

Në përfundim, pas vlerësimit të shpjegimeve të subjektit dhe dokumentacionit të depozituar për periudhën e analizuar 2003 – 2016, balanca totale negative do të ndryshojë nga -10.763.385 lekë në -10.120.387 lekë.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR MBI PASURINË

Nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit vërehet se subjekti nuk ka deklaruar saktë pasurinë dhe janë konstatuar elemente, që mund të ngrenë dyshime për fshehje të pasurisë. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit janë të pamjaftueshme dhe rezultoi në mungesë burimesh të ligjshme financiare për krijimin e tyre.

B. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit 84/2016.

Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit raportin mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës; si dhe (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, DSIK-ja ka dërguar një raport⁴⁶, në përputhje me pikën 2, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të znj. Lindita Sinanaj.*

⁴⁶Me nr. *** prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar me vendimin nr. **, datë 30.3.2021, të KDZh-së.

Në vijim, DSIK-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 23.3.2021, ka përcjellë në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, raporti për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Lindita Sh.Sinanaj, me konstatimin për përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës.

Në vijim të konstatimit fillestar, referon një informacioni shtesë të vitit 2002, duke referuar se konkluzioni për kontrollin e figurës të mbetet në vlerësimin e Komisionit, nën dritën e informacioneve të tjera që mund të disponohen si pjesë e gjetjeve/konstatimeve të dala nga procedurat e hetimit administrativ të thelluar që kryen Komisioni.

Konkluzion për vlerësimin e kontrollit të figurës

Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirje të subjektit të rivlerësimit në veprime korruptive, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Lindita Sinanaj, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Hetimi i Komisionit lidhur me këtë kriter është bazuar në analizimin e:

- raportit⁴⁷ të hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit;
- kriterëve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij).

Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

1. formularit të vetëdeklarimit të paraqitur, tri dokumenteve ligjore të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit Lindita Sinanaj, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti;
2. pesë dokumente ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
3. të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së; si dhe
4. denoncimet e depozituar nga publiku.

Gjetjet nga formulari i vetëdeklarimit dhe dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Subjekti i rivlerësimit Lindita Sinanaj, gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, në datën 27.1.2017 ka paraqitur në Këshillin e Lartë të Drejtësisë aktet vijuese:

- a. formularin e vetëdeklarimit, gjithsej 8 (tetë) fletë;
- b. 21 dokumente shoqëruese të formularit të vetëdeklarimit; lista e inventarit të akteve dhe procesverbali janë pjesë e dosjes së rivlerësimit.

Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit konstatohet se formulari paraqitet i plotë dhe i nënshkruar, pa mangësi e kundërthënie, sipas shtojcës që parashikon ligji.

⁴⁷Raporti nr. *** prot., datë 14.2.2019.

Duke iu referuar të dhënave të deklaruara në formular, konstatohet se nga dhjetori i vitit 1993 deri në nëntor të vitit 2013 subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën e gjyqtares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Nga nëntori i vitit 2013 e deri aktualisht subjekti i rivlerësimit ka kaluar në detyrën e gjyqtares në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

a) Detyrat e kryera 3 vitet e fundit dhe të dhënat statistikore

Subjekti i rivlerësimit Lindita Sinanaj ka deklaruar se tre vitet e fundit ka ushtruar detyrën e gjyqtares në Gjykatën Administrative të Apelit për çdo proces që lidhet me këtë veprimtari deri në dhënien e vendimit, duke përcaktuar fushën e të drejtës administrative pranë kësaj gjykate.

Gjyqtarja Lindita Sinanaj ka deklaruar si specializime: master të nivelit të dytë në Shkencat Penale, sipas kopjes së diplomës nr. ***, datë 10.9.2012, të lëshuar nga Fakulteti i Drejtësisë të Universitetit të Tiranës.

Lidhur me të dhënat statistikore, subjekti i rivlerësimit Lindita Sinanaj ka deklaruar se:

- në vitin 2014 i janë caktuar si kryesuese 1684 çështje dhe ka përfunduar 630 çështje si kryesuese;
- në vitin 2015 i janë caktuar si kryesuese 1236 çështje dhe ka përfunduar 485 çështje si kryesuese;
- në vitin 2016 i janë caktuar si kryesuese 496 çështje; pas kryerjes së procedurës së rishortimit të çështjeve për shkak të ngarkesës së lartë të dosjeve në Gjykatën Administrative të Apelit, numri i çështjeve të caktuara si relatore për vitin 2016 ishte 1325. Në këtë vit ka përfunduar 525 çështje gjyqësore si kryesuese.
- nga viti 2016 deri në vitin 2017 ka mbartur 791 çështje.

Të dhënat statistikore të mësipërme janë shoqëruar me shkresën nr. ** prot., datë 26.1.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. Përmbajtja e këtij vërtetimi konfirmon deklaratimet e subjektit.

b) Trajnimet në tri vitet e fundit

Subjekti i rivlerësimit Lindita Sinanaj ka deklaruar se ka ndjekur 5 trajnime nga Shkolla e Magjistraturës në 3 vitet e fundit.

Po kështu, sa u përket trajnimeve të tjera, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pjesëmarrjen e saj në 9 aktivitete, por vetëm 6 prej tyre i përkasin periudhës së rivlerësimit “tre viteve të fundit”, duke bashkëlidhur edhe dokumentet përkatëse.

c) Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Gjatë periudhës së vlerësimit, subjekti i rivlerësimit Lindita Sinanaj ka përzgjedhur dhe ka paraqitur tri dokumente ligjore, të llojit vendim gjyqësor. Një prej vendimeve i përket vitit 2014, i dyti vitit 2015 dhe vendimi i tretë i përket vitit 2016.

Të dhëna nga burime arkivore të KLD-së

Nga analiza e të dhënave në dosjen personale konstatohet se gjyqtarja Lindita Sinanaj ka marrë titullin “jurist” nga Universiteti i Tiranës, në datën 27.6.1993. Pas studimeve, në datën 15.11.1993, është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, në vijim, më 4.11.2013 Lindita Sinanaj është emëruar gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit, ku vazhdon edhe

aktualisht. Prej vitit 2016 është caktuar me short anëtare e Kolegjit Zgjedhor, sipas nenit 146 të Kodit Zgjedhor.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtaren Lindita Sinanaj janë paraqitur gjithsej 8 ankesa në Inspektoratin e KLD-së (5 ankesa në vitin 2014 dhe 3 ankesa në vitin 2016).

Katër ankesa (3 të vitit 2014 dhe 1 e vitit 2016) janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, me arsyetimin se pretendimet mund të zgjidhen përmes apelimit gjyqësor.

Katër ankesa të tjera janë verifikuar dhe rezultatet janë si vijon:

- i. dy ankesa të vitit 2014 janë verifikuar për zvarritje, nga të cilat njëra është arkivuar, pasi pretendimet ishin të pabazuara dhe tjetra e verifikuar bazuar në informacionin periodik të kryetarit të gjykatës, i është regjistruar gjyqtarës për efekt vlerësimi profesional dhe etik;
- ii. dy ankesa të vitit 2016 janë në proces verifikimi, njëra për zvarritje gjykimi dhe tjetra për mosrespektim formal të ligjit.

Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Lindita Sinanaj përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

ANALIZA E GJETJEVE

Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tre grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; (ii) pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; dhe (iii) të dhënat nga burimet arkivore në ish-KLD-në.

Aftësitë profesionale

a. Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit Lindita Sinanaj ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në aktet e vëzhguara është konstatuar se ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në disa raste evidenton pjesë të ndryshme të legjislacionit (Kodi i Punës apo ligji specifik) për të identifikuar se cila prej tyre duhet të aplikohet, duke analizuar konfliktin e normave në raport me natyrën e mosmarrëveshjes. Kur është rasti, në funksion të nxjerrjes së konkluzioneve për zbatimin e ligjit, ajo përdor referenca në jurisprudencën unifikuese të Gjykatës së Lartë. Për 3 prej 5 dosjeve të vëzhguara palët ndërgjyqëse kanë paraqitur rekurs kundër vendimit të dhënë prej saj dhe pas shqyrtimit të tyre nga Gjykata e Lartë është vendosur mospranimi i rekurseve të ushtruara nga palët. Në 3 prej 5 dosjeve të vëzhguara është konstatuar lënia në fuqi e vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

b. Arsyetimi ligjor

Nga aktet e depozituara rezulton se subjekti i rivlerësimit Lindita Sinanaj ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej saj janë të qarta dhe të kuptueshme. Respekton rregullat e drejtshkrimit në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor.

Struktura e vendimeve përfundimtare përgjithësisht është e standardizuar dhe respekton kërkesat e legjislacionit procedural. Në tekstet e vendimeve përdor pjesë arsyetimi të standardizuara mbi kompetencën e gjykatës, edhe nëse nga palët nuk ka pasur kundërshtime të saj.

Struktura e vendimeve është e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar, duke i shërbyer funksionit të qartësisë së argumentimit ligjor. Përmbajtja e vendimit përfundimtar është gjithëpërfshirës dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve të mosmarrëveshjes dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushtohet rëndësi analizës së normës ligjore në raport me faktet e konstatuara. Niveli i arsyetimit të vendimeve ligjore të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Deri në momentin e hartimit të këtij raporti nuk është identifikuar asnjë rast që të jetë cenuar vendimi nga Gjykata e Lartë.

Aftësitë organizative

a. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit, në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, ka kryer detyrën e gjyqtarit të Gjykatës Administrative të Apelit. Ajo ka deklaruar se në periudhën 2014 – 2016 i janë caktuar për gjykim si kryesuese 4245 çështje gjyqësore dhe ka përfunduar 1640 çështje gjyqësore. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna, është 38,6 %. Nga rishortimi i çështjeve të caktuara në vitin 2016, nga 496 çështje numri i tyre është shtuar në 1325 çështje, ndërsa në vitin 2017 rezulton se gjyqtarja ka mbartur 791 çështje të vitit 2016.

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata Administrative e Apelit, për efekt të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016 gjyqtarja Lindita Sinanaj ka përfunduar gjithsej 1493 çështje gjyqësore, nga të cilat 916 administrative dhe 577 marrëdhënie pune.

Standardet matëse për sasinë dhe shpejtësinë të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve⁴⁸ nuk zbatohen për gjyqtarët e gjykatave administrative, pasi ato janë miratuar nga KLD-ja përpara fillimit të funksionimit të këtyre gjykatave. Megjithatë, nga të dhënat statistikore konstatohet lehtësisht ngarkesa e lartë sasiore që ka pasur gjyqtarja Lindita Sinanaj.

Duke konsideruar të dhënat e analizuara, duhet evidentuar se gjyqtarja Lindita Sinanaj ka pasur ngarkesë të lartë sasiore. Ajo ka pasur disa vonesa në gjykimin e çështjeve që i janë caktuar, duke arsyetuar me vonesë edhe vendimet gjyqësore.

b. Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit Lindita Sinanaj ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore në funksion të zgjidhjes së çështjes. Në 5 dosjet e vëzhguara u konstatua se gjykimet kanë përfunduar me 1 seancë në dhomë këshillimi, të cilat kanë qenë produktive. Në të pesë këto raste tek dosjet e vëzhguara nuk ka pasur asnjë vonesë në caktimin e seancës së parë, sipas standardit të procesit të rregullt.

c. Aftësia për të administruar dosjet

⁴⁸Sistemi i Vlerësimit përmbledh vendimin nr. 261/2, datë 14.4.2010, të KLD-së, "Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve", së bashku me Aneksin I "Kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore", ndërsa gjykatat administrative janë krijuar me ligjin nr. 49/2012 dhe kanë filluar të funksionojnë në datën 4.11.2013.

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short u konstatua se aktet themelore janë të rregullta, të sakta dhe të plota për 4 prej tyre, ndërsa për një të konstatua e administruar në dosje shpallja për gjyqtarin relator B. Sh e që nuk i përkon çështjes së gjyqtarës Lindita Sinanaj.

Për veprimet e kryera është mbajtur procesverbal gjyqësor edhe kur Kolegji ka proceduar në dhomë këshillimi pa pjesëmarrjen e palëve, referuar pikës 3, të nenit 49, të ligjit nr. 49/2012. Në të 5 dosjet është shënuar ora e fillimit të seancës gjyqësore, por nuk është dokumentuar ora e përfundimit të saj.

Në të 5 dosjet e vëzhguara gjendet relatimi i subjektit të rivlerësimit, i nënshkruar në fund prej saj, por pa datë. Në të 5 dosjet gjendet vendimi për caktimin e seancës gjyqësore në dhomë këshillimi. Në fashikull përfshihen aktet e njoftimit të palëve (kopje të listave të gjykimit), të firmosura nga subjekti i rivlerësimit dhe kryetari i gjykatës. Duhet evidentuar se në asnjë rast seancat nuk kanë dështuar për shkak të njoftimeve të parregullta të palëve. Aktet e tjera të përfshira në dosje kanë qenë të sakta dhe në përputhje me kriteret e caktuara nga ligji.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a. Etika në punë

Gjyqtarja Lindita Sinanaj është diplomuar “jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 27.6.1993. Pas studimeve, në datën 15.11.1993, është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier. Në vijim, më 4.11.2013 gjyqtarja Lindita Sinanaj është emëruar gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit, ku vazhdon dhe aktualisht. Prej vitit 2016 është caktuar me short anëtare e Kolegjit Zgjedhor, sipas nenit 146 të Kodit Zgjedhor.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarës Lindita Sinanaj. Edhe nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt.

b. Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Lindita Sinanaj, si dhe nga aktet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c. Paanësia

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Lindita Sinanaj. Për vetë gjyqtarën Lindita Sinanaj në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër, asnjë prej akteve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në aktet e vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Po ashtu nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit Lindita Sinanaj nuk ka respektuar rregullat procedurale.

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a. Aftësitë e komunikimit

Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara në procesverbalin gjyqësor nuk ka të dhëna për mënyrën direkte të komunikimit të subjektit Lindita Sinanaj me palët ndërgjyqëse, pasi këto çështje janë shqyrtuar në dhomë këshillimi pa pjesëmarrjen e palëve, megjithëse në të gjitha rastet subjekti i rivlerësimit ka qenë kryesuese e seancës gjyqësore. Në aktet e vëzhguara gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

b. Aftësia për të bashkëpunuar

Në aktet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit Lindita Sinanaj për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Në të gjitha rastet subjekti i rivlerësimit ka qenë kryesuese dhe ka bashkëpunuar me administratën gjyqësore për të zhvilluar seancën, sipas rregullave procedurale të ligjit nr. 49/2012. Në 5 dosjet është konstatuar se bashkëveprimi me anëtarët e trupit gjykues dhe administratën gjyqësore ka qenë në nivelin e duhur, pasi nuk është konstatuar vonesë në nënshkrimin e vendimit përfundimtar dhe depozitim të dosjes në sekretarinë gjyqësore.

c. Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit Lindita Sinanaj i ka kushtuar rëndësi formimit akademik. Pas disa viteve nga diplomimi “jurist” në vitin 1993, në vitin 2012 ka marrë gradën shkencore “Master i nivelit të dytë” në shkenca penale.

Për shkak të funksionit të gjyqtarit të shkallës së dytë (administrative) që kryen, ajo i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit ka marrë pjesë dhe është certifikuar në 5 trajnime nga Shkolla e Magjistraturës në 3 vitet e fundit.

Rivlerësimi i aftësive profesionale i kryer nga Komisioni

Hetimi i Komisionit, lidhur me këtë kriter, është bazuar në verifikimin dhe analizimin e: (i) raportit për analizimin e aftësisë profesionale të kryer nga KLGJ-ja dhe dokumentacionin bashkëlidhur; (ii) vlerësimit të denoncimeve të paraqitura dhe shqyrtimit të dokumentacionit të dërguar në ankesat e subjekteve denoncuese; si dhe (iii) kriterëve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij).

Komisioni, me qëllim vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale, verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavarur 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, 5 dosjet të përzgjedhura me short, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së.

Pas verifikimit të raportit për analizën e aftësive profesionale të kryer nga KLGJ-ja, 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, 5 dosjeve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të dhënave nga burimet arkivore mbi të cilën është hartuar ky raport, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me vlerësimin profesional.

➤ **Denoncimet e publikut të depozituara në Komision**

Për subjektin e rivlerësimit Lindita Sinanaj janë depozituar 22 denoncime nga publiku, nga të cilat 2 denoncime ishin të përsëritura. Për 3 nga denoncimet e depozituara, subjektit të rivlerësimit i janë kërkuar shpjegime.

Denoncimi nr. *, datë 24.4.2019, i shtetasit Q.V**

Ky denoncues ankohet se trupi gjykues, ku kryesuese ka qenë subjekti i rivlerësimit, është mbështetur në një vendim gjykate i cili rezulton të jetë prishur nga gjykata më e lartë.

Nga analizimi i dokumentacionit rezulton se:

- Në datën 19.11.2015 Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. ***, ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe rrëzimin e padisë. Në pjesën argumentuese kjo gjykatë shprehet: *“Gjykata e Faktit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 9.12.1998, ka vendosur pavlefshmërinë e kontratës së shitjes”*. Në kushtet kur titulli i pronësisë i paraqitur nga paditësi Q.V, është shpallur i pavlefshëm me vendim gjyqësor, atëherë arrihet në përfundimin se kjo kontratë nuk përbën titull pronësie.

- Vendimi nr. ***, ku është bazuar Gjykata Administrative e Apelit në dhënien e vendimit, rezulton të jetë prishur në datën 26.4.1999, me vendim nr. ***, të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe kthimin e çështje për rigjykim.

- Në datën 15.9.1999 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur pushimin e çështjes së mësipërme.

Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit në lidhje me konstatimet e mësipërme.

Subjekti, në prapësimet e depozituara, ka shpjeguar se ka qenë në cilësinë e relatores së trupit gjykues në çështjen me palë paditëse Q.V, të paditur H.V, Rr.Y, H.K dhe Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Vlorë; me objekt *“pavlefshmëri e lejes së legalizimit nr. ***, datë 28.4.2010, në favor të të paditurit H. K”*. Kjo çështje është gjykuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, e cila, me vendimin nr. ***, datë 1.7.2013, ka vendosur *“Pranimin e padisë së paditësit Q.V. Pavlefshmërinë e lejes së legalizimit nr. ***, datë 28.4.2010, në favor të të paditurit H”*.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. ***, datë 19.11.2015, unanimisht ka disponuar: *“Ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 1.7.2013. të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Rrëzimin e padisë së palës paditëse Q. V, si të pabazuar në ligj dhe në prova”*.

Gjykata Administrative e Apelit ka arsyetuar mungesën e legjitimitetit aktiv të paditësit Q. V për dy arsye, duke arsyetuar se: *“Me këtë kërkesëpadi paditësi i është drejtuar gjykatës, duke kërkuar pavlefshmërinë e lejes së legalizimit nr. ***, datë 28.4.2010, të dhënë në favor të të paditurit H.K. Së pari paditësi nuk provon titullin e pronësisë në bazë të të cilit mbështet pretendimet e tij, dhe së dyti nuk provon faktin se në cilat të drejta legjitime është cenuar ai si rezultat i nxjerrjes e lejes së legalizimit nr. ***, datë 28.4.2010, i cili është bërë shkak për ngritjen e kësaj padie”*. Në arritjen e këtij konkluzioni gjykata është referuar në analizën e gjithë të dhënave të akteve të ndodhura në fashikullin e gjykimit, e të administruara si provë në gjykim, e jo në një akt të vetëm.

Kështu, në përmbajtjen e vendimit nr. ***, datë 18.2.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, vendim i cili ka marrë formë të prerë, dhe që është administruar në gjykim si provë, evidentohet se: *“Kontrata e shitblerjes nr. ***, datë 25.4.1995, lidhur midis përfaqësueses së ish-Ndërmarjes Bujqësore Mekanike Vlorë dhe përfaqësuesit të shoqërisë ‘V’ është një veprim juridik absolutisht i pavlefshëm, konform nenit 92, pika ‘a’ e Kodit Civil, për shkak se është kryer në kundërshtim me ligjin...”*.

Subjekti ka shpjeguar se pikërisht kontrata e shitjes, e cila është konstatuar si veprim juridik absolutisht i pavlefshëm në vendimin e mësipërm, është baza e titullit të pronësisë së paditësit Q. V.

Vlerësimi i Komisionit

Në referim të shpjegimeve të mësipërme të dhëna nga subjekti dhe pas shqyrtimit të akteve depozituar prej saj, Komisioni konstaton nuk ka tagrin të analizojë zgjidhjen e çështjes në themel apo të zëvendësojë logjikën e gjyqtarit në arsyetimin e vendimit. Në rastin në fjalë, nga aktet e shqyrtuara nuk konstatohen shkelje të natyrës procedurale si zvarritje të gjykimit, mosdebatim gjyqësor i provave apo shkelje të tjera të kësaj natyre.

Për më tepër, Komisioni konstaton se pretendimet e parashtruara në denoncim nga shtetasi Q. V janë të lidhura me zgjidhjen në themel të çështjes, e cila aktualisht konfirmohet të jetë regjistruar për gjykim në Gjykatën e Lartë, e cila do të shprehet mbi vendimmarrjet e gjykatave të shkallëve më të ulëta.

Në këto rrethana, referuar pikës 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni konstaton se nuk i hyn shqyrtimit të çështjeve që janë ende në proces.

Denoncimet nr. * prot., datë 18.12.2017, nr. ***, datë 29.10.2018 dhe nr. *** prot., datë 8.6.2020, të shtetases S.B.**

Kjo denoncuese ka paraqitur pretendime për 5 subjekte rivlerësimi, ndërmjet të cilëve edhe subjektin Lindita Sinanaj, me pretendimin për dhënie vendimi në mënyrë të padrejtë dhe për veprime korruptive. Denoncuesja pretendon se çështja e saj e shqyrtuar në shkallë të parë është transferuar në gjykatën e apelit me mangësi dokumentacioni.

Gjithashtu, pas një kërkesë me shkrim që denoncuesja ka bërë pranë Gjykatës Administrative të Apelit për pezullim të shqyrtimit të çështjes, bazuar në nenin 297/a të Kodit të Procedurës Civile, pasi paralelisht me shqyrtimin administrativ për çështjen e saj objekt shqyrtimi po zhvillohej një proces penal në një gjykatë tjetër për fallsifikim dokumentacioni, nuk është marrë parasysh kërkesa e saj për pezullimin e gjykimit nga subjekti i rivlerësimit.

Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit në lidhje me konstatimet e mësipërme.

Subjekti, në lidhje me pretendimet e denoncueses, ka argumentuar se i është caktuar për gjykim si relatores çështja nr. *** regj., datë 23.4.2015, që i përket palëve: paditëse S.B dhe të paditur Drejtorja e Përgjithshme e AKU-së Tiranë, me objekt “shfuqizimi tërësisht i aktit administrativ nr. ***, datë 24.11.2014, i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit Tiranë, si akt i pabazuar në prova dhe ligj. Rikthimin në detyrën e mëparshme etj.”.

Kjo çështje është gjykuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, e cila, me vendimin nr. ***, datë 23.3.2015, ka vendosur: “1. Rrëzimin e kërkesëpadisë me nr. *** akti, me paditëse S. B”.

Për zhvillimin e gjykimit në dhomë këshillimi palët janë njoftuar me shpalljen e datës 6.3.2017, në përputhje me parashikimet e nenit 52 të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative”, i ndryshuar, dhe nenit 460 të Kodit të Procedurës Civile. Njëherësh data e gjykimit është publikuar edhe në kalendarin e planifikimit të çështjeve në faqen zyrtare të Gjykatës Administrative të Apelit.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi gjykata, unanimisht, ka konkluduar lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Në pretendimet e parashtruara në denoncim konstatohet se paditësja, midis të tjerave, ka kundërshtuar vendimin e ndërmjetëm të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me të cilin ishte rrëzuar kërkesa e saj për pezullimin e gjykimit.

Subjekti ka shpjeguar se ky pretendim është trajtuar nga Gjykata Administrative e Apelit në dhomë këshillimi, duke e gjetur të pabazuar pretendimin e parashtruar nga paditësja. Konkretisht, lidhur me këtë shkak, Gjykata Administrative e Apelit në vendim arsyeton se: *“Në të kundërt nga sa është pretenduar nga pala paditëse në ankimin e paraqitur, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se në rastin konkret nuk jemi në kushtet kur duhet të pezullohej gjykimi i çështjes për shkak të regjistrimit të procedimit penal për eprorët dhe kolegët e saj, për të cilët paditësja pretendon se kanë bërë ndërhyrje në procesverbalet e mbajtura gjatë ushtrimit të kontrolleve. Në nenin 297 të Kodit të Procedurës Civile është parashikuar se: ‘Gjykata vendos pezullimin e gjykimit kur: (a) çështja nuk mund të zgjidhet para se të zgjidhet një çështje tjetër penale, civile ose administrative; (b) kërkohet nga të dyja palët...’”.*

Subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se gjykata mund të vendosë pezullimin e gjykimit ndër të tjera në ato raste kur çështja nuk mund të zgjidhet përpara se të marrë zgjidhje me vendim gjyqësor të formës së prerë, një çështje tjetër penale, civile ose administrative. Pra, pezullimi i gjykimit të çështjes mund të vendoset nga gjykata vetëm në ato raste kur kjo çështje nuk mund të zgjidhet pa u zgjidhur më parë çështja tjetër e natyrës penale, civile ose administrative. Në rastin konkret, u vlerësua nga trupi gjykues se nuk gjen zbatim dispozita e sipërcituar, për shkak se themeli i çështjes mund të zgjidhet edhe pa marrë zgjidhje çështja penale lidhur me falsifikimin e dokumentacioneve nga kolegët dhe eprorët e paditëses S. B. Në vijim të analizës së mësipërme, për sa kohë që rezulton e provuar se gjatë ushtrimit të detyrës paditësja ka kryer shkelje shumë të rënda, vendimmarrja e palës së paditur për largimin e paditëses nga shërbimi civil do të ishte e njëjtë, edhe në rast se do të prezumohej se procesverbalet e dorëzuara prej saj kanë qenë të rregullta.

Sa më sipër, subjekti shpjegon se kërkesa e paditëses është trajtuar rregullisht nga gjykata, duke dhënë arsyetimin e bazuar në kriteret e dispozitës së zbatueshme dhe të të dhënave të rrethanave të faktit në bazë të akteve të administruara.

Vlerësimi i Komisionit

Në referim të shpjegimeve të mësipërme, nga aktet e shqyrtuara, Komisioni vëren se çështja aktualisht konfirmohet të jetë regjistruar për gjykim në Gjykatën e Lartë, e cila do të shprehet mbi vendimmarrjet e gjykatave të shkallëve më të ulëta. Në këto rrethana, referuar pikës 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, vlerësimi nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë ende në shqyrtim.

Denoncim anonim nr. *, datë 9.7.2020**

Në këtë denoncim ngrihen pretendime dhe akuza për veprime të jashtëligjshme dhe veprimtari korruptive për disa subjekte rivlerësimi të gjykatës Administrative të Apelit, ndërmjet të cilëve edhe Lindita Sinanaj.

Në lidhje me këtë denoncim subjektit iu kërkua të japë shpjegime dhe të depozitojë dokumentacion, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Subjekti ka dhënë shpjegimet e saj, të cilat janë shqyrtuar nga Komisioni. Referuar denoncimit anonim, Komisioni konstaton se në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ky denoncim nuk përmban fakte apo rrethana konkrete që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional për subjektin e rivlerësimit.

Konkluzion lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

Nga hetimi i thellë administrativ i kryer nuk u provua asnjë *indicie* apo element që cenon figurën e gjyqtarës Lindita Sinanaj dhe sipas parashikimeve të nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, është efiçente dhe efektive në masë të pranueshme.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues, në përfundim të hetimit të kryer, në zbatim të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, duke u bazuar në vlerësimin tërësor të çështjes mbi të tria kriteret e rivlerësimit, mbështetur në provat e administruara nga Komisioni, në shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancat dëgjimore publike, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti t’i provojë trupit gjykues të kundërtën e rezultateve të hetimit, duke pasur parasysh se nuk provoi bindshëm: (i) burimet e ligjshme financiare për krijimin e pasurive; (ii) burimet financiare të blerësit për apartamentin e shitur në Fier; (iii) me dokumentacion justifikues dhënia dhe marrja e huas nga huadhënësi dhe, për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit rezulton në pamundësi financiare për blerjen e pasurive, duke u gjendur në parashikimet e pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, si dhe deklarim i pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, në përputhje me pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të germës “c”, të pikës 1, të nenit 58 dhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Lindita Sinanaj, gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.
2. Vendimi, i arsytuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
 4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
- Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 8.7.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Pamela QIRKO
Kryesuese

Suela ZHEGU
Relatore

Lulzim HAMITAJ
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha